

Miftar KURTI

**SHTETET PJESËMARRËSE NË OPERACIONIN “FORCA
ALEATE” DHE KONTRIBUTI I TYRE PËR ÇLIRIMIN E
KOSOVËS (24 mars-20 qershor 1999)**

Abstrakt:

Për shkak se Republika Federative e Jugosllavisë (RFJ) në krye me kryetarin Slobodan Millosheviq nuk i kishte respektuar marrëveshjet e nënshkruara ndërkombëtare, për shkak se i kishte shkelur rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që kishin të bënin me çështjen e Kosovës, për shkak se kishte refuzuar nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë, për shkak se me veprimet e saj po rrezikonte sigurinë e rajonit dhe, për shkak se Ushtria Jugosllave, forcat policore, speciale dhe të sigurisë po vazhdonin terrorin kundër shqiptarëve në Kosovë, atëherë NATO u detyrua të përdorte forcën ushtarake kundër RFJ-së. Të gjitha shtetet anëtare të NATO-s ishin pajtuar për fillimin e bombardimeve, por jo të gjitha shtetet kishin marrë pjesë në operacion dhe jo të gjitha shtetet pjesëmarrëse kishin dhënë kontribut të njëjtë në operacion. Pse ndodhi kështu? Kur filloi dhe kur përfundoi operacioni, cilat ishin arsytet që nuk u përfshinë në operacion të gjitha shtetet, cili ishte kontributi ushtarak i shteteve pjesëmarrëse, cilët ishin disa nga faktorët që e detyruan Millosheviqin të pranonte kushtet e NATO-s për largim nga Kosova? Këto janë disa nga çështjet që do të trajtohen në këtë kumtesë.

Fjalët kyçe: *Kosova, NATO, shtetet, operacioni, RFJ etj.*

Traktati i Atlantikut të Veriut është akti themeltar i NATO-s.¹ Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) u themelua në përgjigje të kërcënimit të paraqitur nga Bashkimi Sovjetik, me qëllim të frenimit të ekspansionizmit sovjetik. Mirëpo, përveç frenimit të ekspansionizmit sovjetik, studiuesit e shohin krijimin e Aleancës edhe si një përpjekje më të gjerë për t'i shërbyer së paku edhe dy qëllimeve tjera: ndalimit të ringjalljes së militarizmit nacionalist në Evropë përmes një pranie të fortë të Amerikës së Veriut në kontinent dhe inkurajimi i integritetit politik evropian.² Traktatit të Atlantikut të Veriut, për një aleancë mbrojtëse, i kanë paraprirë: “Karta e Atlantikut” - Deklarata e Parimeve e lëshuar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara dhe kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar (14 gusht 1941)³; “Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara (28 tetor 1945)”⁴; “Traktati i Brukselit” - Traktati i Bashkëpunimit Ekonomik, social, kulturor dhe vetëmbrojtjes kolektive (17 mars 1948),⁵ dhe “Rezoluta 239 e Senatit Amerikan-Kongresi i 80-të, Sesioni i dytë (“Rezoluta Vandenberg”)", 11 qershor 1948.⁶ Përveç këtyre, themelimit të NATO-s i kanë paraprirë edhe një sërë ngjarjesh dramatike politike, të

¹ The North Atlantic Treaty, Uashington D.C. - 4 April 1949, Last updated: 19 Oct. 2023 18:02 (https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17120.htm, qasja 25.08.2023; David Nauta, *The International Responsibility of NATO and its Personnel during Military Operations*, Doctoral Thesis to obtain the degree of doctor from Radboud University Nijmegen on the authority of the Rector Magnificus prof. dr. J.H.J.M. van Krieken, according to the decision of the Council of Deans to be defended in public on Wednesday, December 21, 2016 at 12.30 hours, University of Amsterdam, The Netherlands, p. 61.

² A SHORT HISTORY OF NATO

(https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_139339.htm, qasja 25.08.2023.)

³ “The Atlantic Charter”-Declaration of Principles issued by the President of the United States and the Prime Minister of the United Kingdom, 14 Aug. 1941, Last updated: 02 Jul. 2018 13:58. (https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_16912.htm?, qasja 01.09.2023).

⁴ Article 51 of the Charter of the United Nations, 24 Oct. 1945, Last updated: 01 Oct. 2009 15:42 (https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_16937.htm?, qasja 01.09.2023).

⁵ “The Brussels Treaty”-Treaty of Economic, Social and Cultural Collaboration and Collective Self-Defence 17 Mar. 1948, Last updated: 01 Oct. 2009 15:31 (https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17072.htm?, qasja 01.09.2023).

⁶ U.S. Senate Resolution 239, 80th Congress, 2nd Session - (“The Vandenberg Resolution”), 11 Jun. 1948, Last updated: 01 Oct. 2009 16:24 (https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17054.htm?, qasja 1.09.2023).

cilat i sollën punët në pikën më të lartë të krizës.⁷ Traktati i Atlantikut të Veriut u nënshkrua më 4 prill 1949 në Uashington nga ministrat e Jashtëm të 12 shteteve: Belgjikës (M. Paul-Henri Spaak), Kanadasë (Lester B. Pearson), Danimarkës (Gustav Rasmussen), Francës (M. Robert Schuman), Islandës (Bjarni Benediktsson), Italisë (Konti Carlo Sforza), Luksemburgut (M. Joseph Bech), Holandës (Dr. DU Stikker), Norvegjisë (Halvard M. Lange), Portugalisë (Dr. Jose Caerio da Matta), Mbretërisë së Bashkuar (Ernest Bevin) dhe Shteteve të Bashkuara (Dean Acheson). Pasi u ratifikua nga parlamentet e vendeve anëtare brenda pesë muajve⁸, Traktati hyri në fuqi më 24 gusht 1949.⁹ Nga viti 1949 e deri në vitin 1999, pjesë e NATO-s u bënë 19 shtete. Greqia¹⁰ dhe Turqia bëhen anëtare të NATO-s në vitin 1952¹¹, duke shtuar numrin në 14 shtete anëtare. Në vitin 1955, Gjermania Perëndimore bëhet anëtare e pesëmbëdhjetë e NATO-s¹², kurse Spanja u bë anëtare e gjashtëmbëdhjetë e NATO-s më 30 maj 1982.¹³ Në Samitin e Madridit, më 8 korrik 1997, NATO-ja ftoi

⁷ A short history of NATO (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_139339.htm, qasja 25.08.2023).

https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_history/20161212_E1-Activation_Treaty.pdf

⁸ https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_history/20161212_E1-Activation_Treaty.pdf, qasja 01.09.2023.

⁹ Founding Treaty, Meet the Signatories (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_137725.htm, qasja 25.08.2023; NATO Archives, *NATO the first five years 1949-1954*, Updated: 11-Jan-2021 (<https://www.nato.int/archives/1st5years/>, qasja 30.08.2023).

¹⁰ Greece and NATO (https://www.nato.int/cps/fr/natohq/declassified_181434.htm, 4.06.2022).

¹¹ Türkiye and NATO (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_191048.htm?selectedLocale=en, qasja 04.06.2022).

¹² Germany and NATO (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_185912.htm, qasja 21.04.2024).

¹³ Spain and NATO (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_195140.htm, qasja 10.01.2024).

Republikën Çeke¹⁴, Hungarinë¹⁵ dhe Poloninë¹⁶ për të filluar negociatat me synimin për t’u bërë anëtare të NATO-s. Këto tri shtete bëhen anëtare të NATO-s më 12 mars 1999.¹⁷ Në shekullin e ri, në fillim të shekullit XXI, saktësisht më 2 prill 2004 në NATO anëtarësohen: Bullgaria¹⁸, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia¹⁹, kurse më 2-4 prill 2008 Shqipëria dhe Kroacia²⁰, Mali i Zi i bashkohet NATO-s më 5 qershor 2017²¹, ndërkaq ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, edhe pse ftohet për t’u bashkuar me aleancën perëndimore në Samitin e 26 liderëve të NATO-s në kryeqytetin e Rumanisë, në Bukuresht²², ajo bëhet anëtare

¹⁴ Czechia and NATO

(https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_223150.htm?selectedLocale=en, qasja 11.05.2024).

¹⁵ Speech by the Prime Minister of Hungary, Viktor Orbn, At the NAC Meeting NATO's Flag Raising Ceremony, Brussels, 16 Mar. 1999

(<https://www.nato.int/docu/speech/1999/s990316c.htm>, qasja 11.05.2024).

¹⁶ Poland and NATO

(https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_223582.htm#:~:text=By%20December%201998%2C%20all%20to%20the%20North%20Atlantic%20Treaty, qasja 11.05.2024).

¹⁷ Jane Perlez, “*Expanding Alliance: The Overview; Poland, Hungary and the Czechs Join NATO*”, *The New York Times*, March 13, 1999, Section A, Page 1

(<https://www.nytimes.com/1999/03/13/world/expanding-alliance-the-overview-poland-hungary-and-the-czechs-join-nato.html>, qasja 15.06.2024).

¹⁸ Evgeniy Kandilarov, “Bulgaria Celebrates 20 years of Joining Nato with a Large Scale Government Program”, Vol. 71, No. 4 (BG) March 2024, ISSN: 2939-5933 (https://china-cee.eu/wp-content/uploads/2024/04/2024er03_Bulgaria.pdf, qasja 15.06.2024).

¹⁹ Seven new members join NATO, 29 Mar. 2004, Last update: 01-Apr-2004 18:28 (<https://www.nato.int/docu/update/2004/03-march/e0329a.htm>, qasja 15.06.2024).

²⁰ Ceremony marks the accession of Albania and Croatia to NATO, 07 Apr. 2009 - Last updated: 07 Apr. 2009 13:16 (https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_52902.htm, qasja 15.06.2024); Albania and Croatia Joined NATO 15 Years ago

(https://ac.nato.int/archive/2024/ALB_HRV_15y_in_NATO, qasja 15.06.2024)

²¹ Montenegro joins NATO as 29th Ally, 05 Jun. 2017-Last updated: 09 Jun. 2017 11:23 (https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_144647.htm, qasja 15.06.2024)

²² David Cutler, “Timeline of key events in NATO's 59-year history”, Editing by Jon Boyle, Reuters, March 31, 2008:38 PM GMT+2Updated 16 years ago

(<https://www.reuters.com/article/us-nato-summit-history-idUSL3151283520080331> qasja 04.06.2022)

e NATO-s më 2020.²³ Aktualisht, në 75-vjetorin e themelimit, NATO-ja ka në përbërjen e saj 32 shtete anëtare (me këtë renditje alfabetike në gjuhën angleze): Shqipëria (anglisht: Albania), Belgjika, Bullgaria, Danimarka, Gjermania, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Britania e Madhe, Italia, Islanda, Kanada, Kroacia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Republika Çeke, Turqia, Hungaria, SHBA-ja.²⁴

Si edhe organizatat e tjera, edhe NATO-ja ka simbolet e saj. NATO-ja konsiderohet të ketë dy simbole të njohura dhe të përdorura shpesh: akronimin NATO (OTAN në frëngjisht) dhe yllin e NATO-s. Shumë më pak i njohur dhe pothuajse tërësisht i harruar është simboli i tretë i NATO-s: *iriqi*, i cili asnjëherë nuk u miratua zyrtarisht nga NATO-ja.²⁵ Simbole tjera të NATO-s konsiderohen *Himni*²⁶ dhe *Alfabeti*.²⁷ Tri kryeqytete kanë qenë mikpritëse të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut që nga krijimi i saj më 1949: Londra, Parisi dhe Brukseli.²⁸ Struktura e NATO-s përgjithësisht përfshin: 1) strukturën civile, administrative, ku përfshihen: Këshilli i Atlantikut të Veriut, i përbërë nga delegacione të përhershme të vendeve të NATO-s; një grup planifikimi bërthamor; stafi ndërkombëtar në selinë e

²³ North Macedonia joins NATO as 30th Ally, 27 Mar. 2020- Last updated: 30 Mar. 2020 09:05 (https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_174589.htm?selectedLocale=en, qasja 15.06.2024).

²⁴ NATO member countries, Last updated: 08 Jun. 2023 16:07 (https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_52044.htm, qasja 06.04.2023 dhe 22.09.2023); [https://www.bundesregierung.de/breg-de/themen/sicherheit-und-verteidigung/nato-faq-206618#:~:text=Die%2031%20Mitgliedstaaten%20der%20NATO,Letland%20\(2004\)%2C%20Litauen%20](https://www.bundesregierung.de/breg-de/themen/sicherheit-und-verteidigung/nato-faq-206618#:~:text=Die%2031%20Mitgliedstaaten%20der%20NATO,Letland%20(2004)%2C%20Litauen%20), qasja 6.04.2023; https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49212.htm, qasja 06.04.2023).

²⁵ A STAR IS BORN (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_136211.htm, qasja 01.08.2023).

²⁶ A NATO HYMN? (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_136214.htm, qasja 31.08.2023).

²⁷ THE NATO PHONETIC ALPHABET (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_136216.htm, qasja 31.08.2023).

²⁸ NATO'S HOMES (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_136208.htm, qasja 31.08.2023).

NATO-s në Bruksel; dhe 2) strukturën ushtarake, ku përfshihen: Komiteti Ushtarak i NATO-s, i cili këshillon Këshillin e Atlantikut të Veriut për strategjinë ushtarake; Komanda Aleate e Operacioneve, përgjegjëse për aktivitetet ushtarake të NATO-s; Komanda Aleate e Transformimit, e cila kujdeset për planifikimin e mbrojtjes dhe zhvillimin e aftësive. Selia e NATO-s është në Bruksel.²⁹ NATO kishte prijësit e saj në periudhën 1950-1999. Ata që e udhëhoqën këtë organizatë me suksese në periudhën kohore 1950-1952 ishin: General Eisenhower dhe Bernard Law Montgomery³⁰, kurse nga viti 1952 e deri në vitin 1999 Sekretar të Përgjithshëm të NATO-s ishin: Lord Ismay (Mbretëria e Bashkuar, 1952-1957); Paul-Henri Spaak (Belgjikë, 1957-1961); Dirk U. Stikker (Holandë, 1961-1964); Manlio Brosio (Itali, 1964-1971); Joseph M.A.H. Luns (Holandë, 1971-1984); Lord Carrington (Mbretëria e Bashkuar, 1984-1988) Manfred Wömer (Gjermani, 1988-1994); Willy Claes (Belgjikë, 1994-1995); dhe Javier Solana (Spanjë, 1995-1999).³¹ Ky i fundit, në luftën e Kosovës 1998-1999, ishte Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s.

NATO-ja, Kosova, Operacioni dhe objektivat

Nuk mund të them saktësisht se kur NATO-ja ka filluar të interesohet për Kosovën, mirëpo mund të them se qëndrimet dhe shqetësimet e saj për Kosovën dalin në pah së paku në dhjetor 1997. Kjo mund të vërehet sapo të lexohet Komunikata përfundimtare nga takimi ministror i Këshillit të Atlantikut të Veriut, mbajtur në selinë e NATO-s, në Bruksel, më 16 dhjetor 1997, ku shprehën shqetësimet

²⁹ NATO (North Atlantic Treaty Organisation) (https://publications.europa.eu/resource/cellar/55442169-d6c1-11e7-a506-01aa75ed71a1.0006.02/DOC_1, qasja 15.05.2024).

³⁰ NATO Leaders, Lord Ismay (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_137930.htm, qasja e fundit 28.07.2024); Lord Ismay NATO Secretary General 1952 - 1957, Last updated: 20 Jun. 2011 12:48, (https://www.nato.int/cps/en/natohq/who_is_who_7294.htm, qasja 28.07.2024).

³¹ NATO Handbook 50th anniversary 1998, *Apendix 2* (https://archives.nato.int/uploads/r/null/1/4/145746/0054_NATO_Handbook_50th_anniversar_y_1998_ENG.pdf, 263-268, qasja 14.07.2024).

për rritjen e tensioneve etnike në Kosovë.³² Pa kaluar as tre muaj të plotë, në Deklaratën e 5 marsit 1998, Këshilli i Atlantikut të Veriut, shprehet thellësisht i shqetësuar, në veçanti për shtypjen brutale nga policia serbe të një demonstrate paqësore në Prishtinë më 2 mars 1998. Këshilli e dënoi pa rezerva shtypjen e dhunshme.³³ Ngase dhuna në Kosovë në muajt shkurt dhe mars mori përmasë terrori, atëherë Këshilli i Atlantikut të Veriut, i mbledhur në nivel të ministrave të Jashtëm më 28 maj 1998, ra dakord për dy objektiva madhorë për NATO-n: 1) të ndihmojë në arritjen e një zgjidhjeje paqësore të krizës; dhe, 2) të promovojë stabilitetin dhe sigurinë në vendet fqinje me theks të veçantë në Shqipëri dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.³⁴ Terrori i vazhdueshëm i forcave serbe dhe jugosllave, shkëlja rezolutave kryesore të Këshillit të Sigurimit (Rezoluta 855, 9 gusht 1993³⁵; Rezoluta 1160, 31 mars 1998³⁶; Rezoluta 1199, 23 shtator 1998³⁷; Rezoluta 1203, 24 tetor 1998)³⁸; dhe refuzimi për ta nënshkruar marrëveshjen e Rambujesë dhe Parisit (shkurt, mars 1999), detyruan NATO-n dhe faktorin tjetër relevant që të veprojnë ushtarakisht me Operacionin “Forca Aleate”. Përveç këtyre, për të arritur deri tek operacioni ushtarak, NATO-ja ka kaluar nëpër disa

³² Final Communiqué-Ministerial Meeting of the North Atlantic Council held at NATO Headquarters, Brussels, 16 Dec. 1997, Last updated: 12 Jan. 2011 14:00, (https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_25439.htm?selectedLocale=en), qasja 22.03.2023.

³³ Council statement on the situation in Kosovo, Press Release (98)29, 5 Mar. 1998 (<https://www.nato.int/docu/pr/1998/p98-029e.htm>, qasja 5.06.2024); *Council statement on the situation in Kosovo*, 5.Mar.1998, Last updated: 13 Jan. 2011,11:54(https://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_25989.htm?selectedLocale=en), qasja 22.03.2023.

³⁴ (<https://www.nato.int/docu/pr/1998/p98-061e.htm#FN1>) qasja 21.03.2023.

³⁵ S/RES/855 (1993), 9 August 1993 (file:///C:/Users/Admin/Downloads/S_RES_855(1993)-EN%20(7).pdf, qasja 31.05.2024)

³⁶ S/RES/1160 (1998) 31 March 1998 (file:///C:/Users/Admin/Downloads/S_RES_1160(1998)-EN.pdf, qasja 31.05.2024)

³⁷ S/RES/1199 (1998) 23 September 1998 (file:///C:/Users/Admin/Downloads/S_RES_1199(1998)-EN.pdf, qasja 31.05.2024)

³⁸ S/RES/1203 (1998) 24 October 1998 (file:///C:/Users/Admin/Downloads/S_RES_1203(1998)-EN.pdf, qasja 31.05.2024)

hapa: Paralajmërim për Aktivizim (ACTWARN) i NATO-s, i kombinuar me Deklaratat e Kërkesave (SOR), Kërkesa për Aktivizim (ACTREQ), Mesazhi i Përgatitjes së Forcave (FORCEPREP), Urdhri për Aktivizim (ACTORD), Mesazhi për Transferimin e Autoritetit (ORBATTOAAIR), Kërkesa për Rregullat e Angazhimit (ROE) (ROE REQ), Mesazhi për Autorizim ROE (ROE AUT) dhe në fund, komandanti suprem i NATO-s, gjenerali Uesli Klark lëshoi një Mesazh Implementimi ROE (ROE IMPL). ROE IMPL u vendos vetëm pas dështimit të negociatave të Rambujesë dhe Parisit (shkurt, mars 1999). ROE IMPL është urdhri zyrtar i përdorur nga komandanti suprem për të filluar operacionin.³⁹ Gjithashtu, NATO-ja, në kontekst të situatës në Kosovë gjatë vitit 1998 deri tek Operacioni “Forca Aleate” (OFA) mori disa masa, kreu stërvitje dhe realizoi disa operacione, të cilat mund t’i quajmë testuese, paraprijëse për OFA-n. Ato janë: Stërvitja “Skifter i vendosur” (15 qershor 1998), i cila është quajtur edhe operacion⁴⁰; Operacioni “Cobalt Flash”⁴¹; Operacioni “Forca e Përcaktuar” (“Determined Force”)⁴²; Operacioni “Syri i Shqiponjës” (“Eagle Eye”)⁴³; Operacioni “Flexible Anvil” dhe “Sky

³⁹ Oberst M. Svejgaard og Major K. Nødskov, Flyvertaktisk Kommando, *Luftstridskæfters anvendelse under Operation “Allied Force”*,

<https://krigsvidenskab.dk/emne/luftstridskæfters-anvendelse-under-operation-allied-force>, Publikuar më 2 Mars. 1999, qasja 7.04.2023; Steps NATO must take for airstrike approval, October 8, 1998

Web posted at: 10:18 a.m. edt (1418 GMT)

(<http://edition.cnn.com/ËORLD/europe/9810/08/kosovo.nato.steps/>, qasja 05.12.2023).

⁴⁰ Exercise Determined Falcon Operation Determined Falcon

(https://web.archive.org/web/20150901011041/http://www.globalsecurity.org/military/ops/determined_falcon.htm, qasja 16.11.2023).

⁴¹ Operation Cobalt Flash-

https://web.archive.org/web/20150920033931/http://www.globalsecurity.org/military/ops/cobalt_flash.htm, qasja 16.11.2023).

⁴² Operation Determined Force

(https://web.archive.org/web/20150901011046/http://www.globalsecurity.org/military/ops/determined_force.htm, qasja 16.11.2023).

⁴³ Operation Eagle Eye

Operation Joint Guarantor / Determined Guarantor

(https://web.archive.org/web/20150901081656/http://www.globalsecurity.org/military/ops/eagle_eye.htm, qasja 16.11.2023).

Anvil” dhe Operacioni “Noble Anvil”.⁴⁴ Ky i fundit ishte pjesë e Operacionit “Forca Aleate” (nga SHBA). Kishte disa propozime lidhur me emërtimin e operacionit, por në fund u vendos që fushata ajrore zyrtarisht të emërtohet Operacioni “Forca Aleate” (“Allied Force”).⁴⁵ Ishte Javier Solana, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, i cili më 24 mars *urdhëroi* komandantin suprem, gjeneralin W. Klark, që të fillonte bombardimet kundër RFJ-së, por ishte gjithashtu vetë Solana ai, i cili më 10 qershor 1999, pezulloi bombardimet, kurse më 20 qershor 1999 e shpalli të përfunduar zyrtarisht Operacionin “Forca Aleate” (OFA) kundër Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ).⁴⁶

Operacioni “Forca Aleate” u krye përmes *kanaleve të komandës* së NATO-s dhe SHBA-së. Komandanti i përgjithshëm ishte gjenerali Wesli Clark.⁴⁷ Komanda dhe kontrolli i Operacionit “Forca Aleate” përbante dy linja specifike. E para, ishte specifike për Shtetet e Bashkuara.⁴⁸ E dyta ishte Korpusi i Reagimit të Shpejtë Aleat, i komanduar nga gjenerallejtënant Michael Jackson (MB), i cili gjithashtu shërbeu si komandant i Komponentit Tokësor të Forcës së Përbashkët të Kombinuar. Shtetet e Bashkuara kishin *dy task* forca të përbashkëta që ishin nën kontrollin operacional (OPCON) të komandantëve amerikanë: Task Forca e Përbashkët e Operacioneve Speciale (OPCON në EUCOM) dhe Task Forca e Përbashkët e Operacioneve Psikologjike (OPCON te JTF “Noble Anvil”).⁴⁹ NATO-

⁴⁴ Operation Noble Anvil, Operation Flexible Anvil, Operation Sky Anvil (<https://web.archive.org/web/20150506124419/http://www.globalsecurity.org/military/ops/noble-anvil.htm>, qasja 16.11.2023).

⁴⁵ Gjeneral Wesley K.Clark, *Të bësh luftë moderne*, Artini, Prishtinë, 2022, 224.

⁴⁶ Valérie Peclow, Georges Bergehezan et Bernard Adam, *Bilan de la guerre du Kosovo*, le résultat des frappes - la fin du conflit la reconstruction - La situation en Serbie-Monténégro, RAPPORT DU GRIP 2000/3, 10.

⁴⁷ <https://www.nato.int/pictures/1999/990325/b9903252.jpg>, qasja e fundit 14.07.2024

⁴⁸ Jason E. Fritz, Stability Operations in Kosovo 1999-2000: A case study, Piksoi, January 2018, 27, 28 (<https://pksoi.armywarcollege.edu/wp-content/uploads/2020/06/Kosovo-issue-paper.pdf>, qasja e fundit 15.08.2024).

⁴⁹ Jason E. Fritz, Stability Operations in Kosovo 1999-2000: A case study, Piksoi, January 2018, 27, 28 (<https://pksoi.armywarcollege.edu/wp-content/uploads/2020/06/Kosovo-issue-paper.pdf>, qasja e fundit 15.08.2024).

ja kishte objektiva politike, ushtarake, strategjike dhe gjeopolitike, mirëpo në rastin e OFA-s dhe Kosovës për të arritur konsensusin, për të ruajtur kohezionin midis anëtarëve të aleancës, NATO-ja kishte objektiva të kufizuara.⁵⁰ Aleanca e NATO-s, një ditë para fillimit të operacionit, më 23 mars 1999, njoftoi objektivat fillestare *politike* dhe *ushtarake* të saj. Objektivat politike ishin: (1) të ndihmonin në arritjen e një zgjidhjeje paqësore të krizës në Kosovë dhe (2) të ndalonin dhunën dhe të mbështesin përfundimin e negociatave për një zgjidhje të përkohshme politike.

Objektivat përkatëse ushtarake të aleancës së NATO-s në fushatën ajrore ishin: (1) ndalimi i sulmit të dhunshëm të kryer nga Ushtria Jugosllave dhe forcat e sigurisë, (2) pengimi i aftësisë së tyre për të kryer sulme të ardhshme kundër popullatës së Kosovës dhe (3) mbështetja e përpjekjeve ndërkombëtare për të siguruar marrëveshjen e Republikës Federative të Jugosllavisë për një zgjidhje të përkohshme politike.⁵¹ Në Takimin Ministror të Këshillit të Atlantikut të Veriut, të mbajtur më 12 prill 1999, NATO-ja zgjeroi objektivat e saj duke përcaktuar pesë kërkesa për përfundimin e fushatës ajrore,⁵² të cilat u rikonfirmuan nga krerët e shteteve dhe qeverive në Uashington gjatë Samitit të 50-vjetorit të NATO-s më 23 prill 1999.⁵³ Krerët e shteteve dhe qeverive pjesëmarrëse në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut në Uashington, DC, më 23-24 prill 1999, pasi

⁵⁰ United States General Accounting Office, Report to Congressional Requesters, *Kosovo Air Operations Need to Maintain Alliance Cohesion Resulted in Doctrinal Departures*, July 2001, 20.

⁵¹ United States General Accounting Office, Report to Congressional Requesters, *Kosovo Air Operations Need to Maintain Alliance Cohesion Resulted in Doctrinal Departures*, July 2001, 20.

⁵² United States General Accounting Office, Report to Congressional Requesters, *Kosovo Air Operations Need to Maintain Alliance Cohesion Resulted in Doctrinal Departures*, July 2001, 20. (<https://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-051e.htm>, qasja 22.03.2023).

⁵³ The Washington Declaration, Signed and issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington D.C. on 23rd and 24th April 1999, Updated: 23 April 1999, qasja 22.03.2023; Anthony H. Cordesman, *The Lessons and Non-Lessons of the Air and Missile Campaign in Kosovo*, Revised August, 2000, 23-24.

konstatojnë se situata në Kosovë paraqet një sfidë themelore për vlerat për të cilat NATO-ja ka qëndruar që nga themelimi i saj: demokracinë, të drejta e njeriut dhe sundimin e ligjit dhe, pasi konstatojnë se situata në Kosovë është kulmi i një politike të qëllimshme shtypjeje, spastrimi etnik dhe dhunë të ndjekur nga regjimi i Millosheviqit; publikojnë pesë kushtet, të cilat duhej t'i plotësonte RFJ-ja e Millosheviqit: 1) ndalimi i verifikueshëm i të gjitha veprimeve ushtarake dhe përfundimi i menjëhershëm i dhunës dhe represionit; 2) tërheqja nga Kosova e forcave ushtarake, policore dhe paraushtarake; 3) vendosja në Kosovë e një pranie ushtarake ndërkombëtare; 4) kthimi i pakushtëzuar dhe i sigurt i të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur dhe qasje e papenguar tek ata nga organizatat e ndihmës humanitare; 5) vendosja e një marrëveshjeje kornizë politike për Kosovën në bazë të Marrëveshjes së Rambujesë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara.⁵⁴ Lidhur me tërheqjen e forcave serbe, NATO-ja më pas specifikoi se të gjitha forcat e Beogradit (RFJ-së) duhet të largohen nga Kosova, në ndryshim nga marrëveshjet e mëparshme (Rambuje-M.K.) që do t'i lejonin Beogradit të mbante disa forca në Kosovë.⁵⁵

Strategjia, me të cilën u fillua operacioni, shkruan në kujtimet e tij komandanti suprem i Aleancës, gjenerali Klark, u dëshmuar si jashtëzakonisht e vështirë, jo vetëm për arsye se aleatët nuk ishin në gjendje të sulmonin forcat tokësore me shpejtësinë që dëshironin, por edhe për arsye se diskutimet politike dhe aktivitetet diplomatike po dërgonin porosi të përziera. Ishte kjo kundërthënia më qenësore në cilëndo strategji, në të cilën përdorimi i forcës kombinohet me diplomaci të vazhdueshme.⁵⁶ Një element tjetër shumë sfidues ishte

⁵⁴ NATO's 17-Point Statement on Kosovo By *The Associated Press*, Friday, April 23, 1999; 2:10 p.m. EDT (<https://www.washingtonpost.com/wp-srv/inatl/longterm/balkans/stories/natopoints.htm>, qasja 22.07.2024)

⁵⁵ Af Oberst M. Svejgaard og Major K. Nødskov, *Flyvertaktisk Kommando, Luftstridskræfters anvendelse under Operation "Allied Force"*, <https://krigsvidenskab.dk/emne/luftstridskraefters-anvendelse-under-operation-allied-force>, Publikuar më 2 Mars. 1999, qasja 07.04.2023.

⁵⁶ Gjeneral Wesley K.Clark, *Të bësh luftë moderne*, Artini, Prishtinë, 2022, 259.

përcaktimi dhe vlerësimi i caqeve që duhej të goditeshin nga NATO-ja gjatë Operacionit kundër Serbisë dhe RFJ-së. Si rezultat i përpjekjeve për të ruajtur kohezionin e NATO-s, procesi i përzgjedhjes së caqeve ishte shumë i komplikuar.⁵⁷ Plani operacional i operacionit filloi të përgatitet në verën e vitit 1998. Sipas planifikimit, operacioni fillimisht duhej të kalonte nëpër pesë faza. Kjo nuk ndodhi.⁵⁸ Shpалosja e Operacionit “Forca Aleate” në realitet do të përbëhet nga tri faza: faza e parë filloi më 24 mars dhe zgjati deri më 27 mars 1999, faza e dytë zgjati nga 27 deri më 31 mars, kurse faza e tretë, e cila filloi më 1 prill 1999 zgjati deri në qershor.⁵⁹ Faza e fundit e fushatës ishte më e gjata dhe zgjati deri më 10 qershor 1999, kur përfunduan bombardimet.⁶⁰

Shtetet pjesëmarrëse në Operacion dhe kontributi i tyre

Më 24 mars 1999, në ditën e fillimit të Operacionit *Forca Aleate* (OFA), NATO-ja kishte në përbërjen e saj 19 shtete anëtare: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Francën, Gjermaninë, Italinë, Belgjikën, Kanadanë, Republikën Çeke, Danimarkën, Greqinë, Hungarinë, Islandën, Luksemburgun,

⁵⁷ Benjamin S., Lambeth, *NATO’s Air War for Kosovo: a strategic and operational assessment/Rand*, 2001, p.186, 187, 188.

⁵⁸ Raport to Congress, *Kosovo/Operation Allied Force After-Action Report*, Unclassified, 31 January, 2000, p.7-8, qasja 9.01.2023); (Plt Ludovic Monnerat, *Une année après, le bilan militaire de la guerre du Kosovo montre que le “tout aérien” relève plus du mythe que de la révolution*, 24 mars 2000, <https://www.checkpoint-online.ch/Checkpoint/Monde/Mon0014-BilanGuerreKosovo.html> qasja 25.01.2023.

⁵⁹ Valérie Peclow, Georges Bergehezan et Bernard Adam, *Bilan de la guerre du kosovo*, le résultat des frappes - la fin du conflit la reconstruction - la situation en serbie-monténégro, Rapport du grip 2000/3, 13.

⁶⁰ TURNING POINT: Operation *Allied Force* and the allure of Air Power A thesis presented to the Faculty of the U.S. Army Command and General Staff College in partial fulfillment of the requirements for the degree MASTER OF MILITARY ART AND SCIENCE Art of War Scholars by Robert H. Gregory, Maj, U.S. Army B.S., United States Military Academy, West Point, New York, 2003 M.A., Naval Postgraduate School, Monterey, California, 2008 Fort Leavenworth, Kansas 2014-01, 71, 72.

Holandën, Norvegjinë, Poloninë, Portugalinë, Spanjën dhe Turqinë.⁶¹ Edhe pse secili nga 19 aleatët miratoi objektivat e luftës, jo të gjitha shtetet anëtare të NATO-s morën pjesë në sulmet ajrore.⁶² Gjashtë shtete anëtare të Aleancës Atlantike nuk janë përfshirë drejtpërdrejt në operacionet ajrore: Greqia, Islanda, Luksemburgu, Republika Çeke, Polonia dhe Hungaria.⁶³ Dy shtete: Shqipëria dhe Maqedonia, edhe pse nuk kishin anëtare të NATO-s, kontribuan si shtete të “vijës së parë”, në mënyrë të veçantë dhe pa asnjë kufizim Shqipëria.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA)⁶⁴ si njëra nga shtetet themeluese të NATO-s⁶⁵, gjithmonë ka luajtur rol të pazëvendësueshëm në NATO. Gjenerali amerikan, Dwight Eisenhower, u emërua komandanti i parë i Forcave Aleate (SACEUR) në dhjetor 1950.⁶⁶ Që nga themelimi e deri më 1999 komandanti suprem (SACEUR) ka qenë nga Forcat e SHBA-së.⁶⁷ Ndërkaq komandant suprem i NATO-s për Evropë gjatë luftës së Kosovës

⁶¹ Anthony H. Cordesman Arleigh A. Burke Chair in Strategy, *The Air and Missile Campaign in Kosovo*, 9/17/03, p.30.

⁶² Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, CRS Report for Congress, Received through the CRS Web, Congressional Research Service @ The Library of Congress, November 19, 1999, p.19,20,21,22,24.

⁶³ Valérie Peclow, Georges Berghezan et Bernard Adam, *Bilan de la guerre du Kosovo*, le résultat des frappes - la fin du conflit la reconstruction - la situation en Serbie-Monténégro, RAPPORT DU GRIP 2000/3, p.11.

⁶⁴ Mark C.Cornesm John A.Garraty, *Historia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës* (përkthyer: Andi Pinari, Eva Hyskaj, Kujtim Ymeri, Mariana Ymeri, Mira Kroqi, SHB “Diturua”, Tiranë, 216.

⁶⁵ The United States and NATO

(https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_162350.htm, qasja 27.08.2023)

⁶⁶ Dwight D. Eisenhower (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_137961.htm, qasja 27.08.2023).

⁶⁷ NATO Library, *NATO Military Command Structure*, NATO Resources, List of Major NATO Commanders (1951-2000), 5 December 2000, 1., (<https://natolibguides.info/mcs>, qasja 20.11.2023); Lyman Louis Lemnitzer (<https://www.jcs.mil/About/The-Joint-Staff/Chairman/General-Lyman-Louis-Lemnitzer/>, qasja 07.12.2023).

1998-1999 dhe gjatë Operacionit “Forca Aleate” ishte gjenerali amerikan, Welsi Klark.⁶⁸

SHBA-ja për shkak të forcës dhe autoritetit të tyre në arenën ndërkombëtare, përbënin faktorin më të rëndësishëm dhe më me peshë në Organizatën e Atlantikut të Veriut dhe në Grupin e Kontaktit.⁶⁹ Çështja e intervenimit ushtarak të NATO-s në Kosovë ishte prioritet i politikës amerikane.⁷⁰ SHBA-ja është konsideruar si faktor vendimtar për aktivitetin luftarak dhe suksesin e NATO-s në Kosovë.⁷¹ Pa SHBA-në nuk bëhej, asgjë nuk do të ndodhte.⁷² As Operacioni “Forca Aleate”. Që nga fundi i vitit 1997, para Administratës së Bill Clintonit ishte shtruar çështja e ndërhyrjes ushtarake për të parandaluar dëbimin dhe vrasjen e popullatës shqiptare në Kosovë, për të parandaluar përsëritjen e përvojave nga Bosnjë- Hercegovinës (BH) si dhe për t’i përmbushur kërcënimet nga “Paralajmërimi i Krishtlindjeve” të presidentit të SHBA-së, Xhorxh Bush, i vjetri, të cilat administrata e Clintonit i kishte aktualizuar shumë herë.⁷³ Edhe pse çorba e politikave rreth Kosovës në Departamentin e Shtetit gatuhet nga shumë kuzhinierë, Sekretarja e Shtetit, Albright, ishte figura kyçe në Uashington e politikës së sertë të SHBA-së rreth Kosovës.⁷⁴ Ushtria dhe politika amerikane e mbrojtjes edhe në proceset e shpërbërjes së RFJ-së, edhe në rastin e Kosovës, kanë pasur një rol shumë të rëndësishëm që ka ndikuar në përkufizimin e zgjidhjeve dhe të veprimeve politike.⁷⁵ Përdorimi i forcës nga NATO-ja në rastin e

⁶⁸ General Wesley K. Clark, Former NATO Supreme Allied Commander Europe (<https://www.thegreatcourses.com/professors/eesley-k-clark>), qasja 01.12.2023; CNN Editorial Research, *Wesley Clark Fast Facts*, Updated 4:12 PM EST, Wed December 6, 2023, qasja 07.12.2023).

⁶⁹ Hamit Kaba, “*Justifikimi i intervenimit të NATO-s në Kosovë në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare*”, *Kosova*, nr. 48, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2023, 236.

⁷⁰ Abër Hadri, “*Ultimatumi i presidentit Bill Clinton dhe përgatitjet për intervenimin ushtarak në Kosovë (shtator-tetor 1998)*”, *Kosova*, nr. 47, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2002, 153.

⁷¹ Kudusi Lama, *Kosova dhe Ushtria Çlirimtare*, Tiranë, 2005, 367.

⁷² Tony Blair, *Një rrugëtim*, SHB 55, Tiranë, 2011, 279.

⁷³ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, 193.

⁷⁴ James W.Pardew, *Paqebërësit*, Koha, Prishtinë, gusht 2021, 196, 197.

⁷⁵ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova...*, 72-81

Kosovës nuk mund të bëhej pa SHBA-në, sepse një gjë ishte krejtësisht e qartë: 85 për qind e mjeteve të përdorura do të ishin amerikane.⁷⁶ Përfshirjes së forcave amerikane në operacionin *Forca Aleate*, i kanë paraprirë: Operacioni “Cobalt Flash” (10 tetor-10 nëntor 1998)⁷⁷; “Flexible Anvil” dhe “Sky Anvil”⁷⁸ dhe Operacionin “Noble Anvil”.⁷⁹ Ky i fundit ishte komponent amerikan në kuadër të Operacionit *Forca Aleate* të NATO-s. Të dy operacionet (“Noble Anvil” dhe “Forca Aleate”), njëri brenda tjetrit, kishin qëllimet e përbashkëta. SHBA-ja ishte në krye të Komandës së OFA-s. Kjo dëshmohet edhe me faktin se gjenerali amerikan, Klark, ishte komandant suprem i NATO-s për Forcat Aleate. Gjeneral amerikan Short, shërbeu si komandant i Forcave të Gjashtëmbëdhjetë Ajrore dhe Forcave Ajrore Aleate të Evropës Jugore (AIRSOUTH) dhe drejtoi fushatën ajrore nga Qendra e Operacioneve të Kombinuara Ajrore (CAOC) të NATO-s në Vicenza (Itali). Më 19 shkurt 1999, Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara në Evropë (USAFE) aktivizuan Task Forcën 16 të Ekspeditës Ajrore dhe Hapësinore “Noble Eagle”, me seli në Aviano (Itali), jo shumë larg Venecias, për të mbështetur Operacionin “Forca Aleate”. Në të njëjtën kohë, USAFE aktivizoi gjithashtu Krahun 16 dhe Krahun 31 të ekspeditës ajrore në Aviano dhe Krahun 100 të ekspeditës ajrore në RAF Mildenhall, në Mbretërinë e Bashkuar.⁸⁰ Gjatë Operacionit “Forca

⁷⁶ Tony Blair, *Një rrugetim*, SHB 55, Tiranë, 2011, 279.

⁷⁷ Operation Cobalt Flash

(https://web.archive.org/web/20150920033931/http://www.globalsecurity.org/military/ops/cobalt_flash.htm, qasja 16.11.2023).

⁷⁸ Operation Flexible Anvil, Operation Sky Anvil

(<https://web.archive.org/web/20150920061537/http://www.globalsecurity.org/military/ops/noble-anvil.htm>, qasja 16.11.2023)

⁷⁹ Operation Noble Anvil/ Operation Flexible Anvil/ Operation Sky Anvil

(<https://web.archive.org/ëeb/20150506124419/http://www.globalsecurity.org/military/ops/noble-anvil.htm>, qasja 16.11.2023).

⁸⁰ Daniel L. Haulman, *The U.S. Air Force in the Air War Over Serbia, 1999*, *Air Power History* / Summer 2015, Volume 62, Number 2, www.afhistoricalfoundation.org p.10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18; Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, f. 195-198, 218-220; Capt Gregory Ball, USAFR, Ph.D, 1999 - Operation Allied Force

Aleate”, forcat ajrore amerikane ranë nën kontrollin e Forcave të Gjashtëmbëdhjetë Ajrore të USAFE.⁸¹ Përveç njësiteve të Forcës Gjashtëmbëdhjetë Ajrore, në OFA janë përfshi edhe forca nga Forca e Tretë Ajrore Amerikane. Forca e Tretë Ajrore (USAFE) udhëhoqi pjesën humanitare të Operacionit “Forca Aleate”.⁸² Krahu 48 Fighter [48th FW], si pjesë e Forcës së Tretë Ajrore, me bazë ajrore Cervia (Itali),⁸³ Krahu 52 luftarak, në bashkëpunim me krahët e Forcave Ajrore të SHBA-së në Evropë (USAFE) në bazën ajrore Ramstein (Gjermani) mbështetën drejtpërdrejt misionin e lëvizshmërisë strategjike të kryer dikur në bazën ajrore Rhein-Main (Gjermani). Operacioni “Forca Aleate” doli të ishte përpjekja më e madhe ushtarake e ndërmarrë nga Krahu 52 luftarak që nga Operacioni “Stuhia e Shkretëtirës”.⁸⁴ Për të marrë pjesë në Operacionin “Forca Aleate”, Forcat Ajrore Amerikane aktivizuan edhe Krahun 100 të Ekspeditës Ajrore të Forcës së Pestë Ajrore të Kombinuar.⁸⁵ SHBA-ja

(<https://www.afhistory.af.mil/FAQs/Fact-Sheets/Article/458957/1999-operation-allied-force/>, qasja 15.08.2023); Operation Noble Anvil/ Operation Flexible Anvil/Operation Sky Anvil (<https://web.archive.org/web/20150506124419/http://www.globalsecurity.org/military/ops/noble-anvil.htm>, qasja 16.11.2023).

⁸¹ United States Air Forces in Europe (USAFE)/United States Air Forces Africa (AFAFRICA)

(<https://web.archive.org/web/20150419065616/http://www.globalsecurity.org/military/agency/usaf/usafe.htm>, qasja 16.11.2023).

⁸² Third Air Force

(<https://web.archive.org/web/20150907045003/http://www.globalsecurity.org/military/agency/usaf/3af.htm>, qasja 7.12.2023).

⁸³ 494th Fighter Squadron [494th FS]

(<https://web.archive.org/web/20150926063846/http://www.globalsecurity.org/military/agency/usaf/494fs.htm>, 7.12.2023).

⁸⁴ 84 52nd Fighter Wing (52 FW)

(<https://web.archive.org/web/20150911115223/http://www.globalsecurity.org/military/agency/usaf/52fē.htm>, qasja 7.12.2023).

⁸⁵ RAF FAIRFORD, USAF Air Base History; John P. Williamson, 100th Air Refueling Wing historian (<https://www.raf-fairford.co.uk/operation-allied-force/>, qasja 15.11.2023); John P. Williamson, *March marks 10th anniversary of Operation Allied Force*, Published, March 17, 2009.

aktivizoi dhe Krahun 92 të karburantit.⁸⁶ Forcat Ajrore Amerikane kontribuan me gjysmën e totalit të aseteve ajrore dhe një pjesë edhe më të madhe të avionëve të aftë për furnizim me karburant, zbulim dhe armë precize.⁸⁷ Po ashtu, Komanda e Operacioneve Speciale të Forcave Ajrore për personel dhe avion kreu misione të rëndësishme fluturimi gjatë Operacionit. Gjatë operacionit, organizatat e Komandës së Lëvizshmërisë Ajrore kryen 2 130 fluturime në misione ajrore.⁸⁸

Nëse deri në fund të operacionit, NATO-ja kishte mbledhur mbi 1 000 avionë në rajon, atëherë vetëm Shtetet e Bashkuara dhanë mbi 700, kurse aleatët e tjerë të NATO-s kontribuan me pjesën e mbetur. Nga më shumë se 700 avionë amerikanë, mbi 500 avionë me krahë fikse u vendosën në 22 baza tokësore në 8 vende, 70 për qind e avionëve me bazë tokësore amerikane i përkisnin Forcave Ajrore dhe 30 për qind Marinës dhe Trupave Detare. SHBA-ja ishte furnizuesi kryesor i avionëve luftarakë për këtë operacion.⁸⁹ Me mbi 400 avionë USAF “mobiloj” 29 552 nga 38 004 fluturimet e NATO-s. Nga 28 018 municione të shpenzuara nga NATO-ja, USAF-i dorëzoi 21 120. Forcat Ajrore Amerikane hodhën më shumë se 650 municione të reja të sulmeve të përbashkëta direkte (JDAM), të cilat rezultuan të ishin më të sakta se bombat tradicionale, sepse sinjalet satelitore GPS i

⁸⁶ Jim O'Connell, *The 92 ARW, Total Force Teamwork in Operation Allied Force*, Published March 21, 2016

(<https://www.fairchild.af.mil/News/Features/Display/Article/763052/the-92-arw-total-force-teamwork-in-operation-allied-force/>; <https://www.afhra.af.mil/About-Us/Fact-Sheets/Display/Article/432713/92-operations-group-amc/>; <https://www.fairchild.af.mil/Information/Fact-Sheets/Display/Article/238995/team-fairchild/qasja-29.11.2023>).

⁸⁷ Lt Gen William J. Begert, USAF, *Kosovo and Theater Air Mobility*, Aerospace Power Journal Winter 1999, 11,12, 14-18, 21.

⁸⁸ Daniel L. Haulman, “*The U.S. Air Force in the Air War Over Serbia, 1999*”, *Air Power History / Summer 2015*, Volume 62, Number 2, www.afhistoricalfoundation.org, 10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18.

⁸⁹ *Kosovo Air Operations Combat Aircraft Basing Plans Are Needed in Advance of Future Conflicts*, United States General Accounting Office, Report to the Chairman, Committee on Armed Services, House of Representatives, GOA, May 2001, GAO-01-461, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8,10.

drejtonin ato.⁹⁰ Forcat Ajrore të SHBA-së shpenzuan gjithsej 8 618 tonë municione. Së fundi, burimet e inteligjencës amerikane dhanë 99 për qind të nominimeve të synuara për fushatën ajrore, sepse NATO-ja varej pothuajse tërësisht nga teknologjia e Shteteve të Bashkuara për të lidhur informacionin e inteligjencës me operacionet.⁹¹ Shtabi i Përbashkët i Departamentit të Mbrojtjes në mënyrë të përmbledhur ka publikuar këto të dhëna në formë statistikore për fushatën ajrore 78-ditore në këtë kuadër edhe ato kanë të bëjnë me SHBA-në dhe kontributin e tyre. Llojet totale: 37 200; SHBA: 23 208 (62%); Aleatët: 13 992 (38%); llojet e goditjes: 9 500; SHBA: 5 035 (53%), Aleatët: 4 465 (47%); llojet e inteligjencës/zbulimit: 1 200; SHBA: 948 (79%), Aleatët: 252 (21%); llojet mbështetëse: 26 500; SHBA: 17 225 (65%), Aleatët: 9 275 (35%).⁹² Gjatë operacionit Forca Aleate kontribuoi edhe aviacioni detar me bazë tokësore EA-6B Prowlers, EP-3E Aries II dhe F/A-18D Hornets. Performanca e Grupit të *Betejës Roosevelt* është e dukshme për sukseset e shumta.⁹³ Korpusi Detar i SHBA-së ka pasur rreth 6 000 orë fluturimi në mbështetje të operacioneve në Kosovë.⁹⁴ Marina e Shteteve të Bashkuara vendosi anije të armatosura me raketa lundrimi Tomahawk Attack Toka (TLAM) në Detin Adriatik, pak larg bregut perëndimor të

⁹⁰ Daniel L. Haulman, *The U.S. Air Force in the Air War Over Serbia, 1999*, *Air Power History / Summer 2015*, Volume 62, Number 2, www.afhistoricalfoundation.org, 10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18.

⁹¹ Daniel L. Haulman, “*The U.S. Air Force in the Air War Over Serbia, 1999*”, *Air Power History / Summer 2015*, Volume 62, Number 2, www.afhistoricalfoundation.org, 10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18.

⁹² *CRS Report for Congress, Bosnia and Kosovo: U.S. Military Operations, February 16, 2004, name redacted Specialist in National Defense Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Congressional Research Service ~ The Library of Congress, 10.*

⁹³ Naval History and Heritage Command, *Operation Allied Force 1999*, Published: Thu Sep 07 11:40:01 EDT 2023, (<https://www.history.navy.mil/browse-by-topic/wars-conflicts-and-operations/allied-force.html>, qasja 30.11.2023).

⁹⁴ Kosovo Naval Lessons Learned During Operation *Allied Force* March-June 1999, Published: Fri Oct 13 12:54:34 EDT 2017 (<https://www.history.navy.mil/research/library/online-reading-room/title-list-alphabetically/k/kosovo-naval-lessons-learned-during-operation-allied-force.html>, qasja 30.11.2023).

Jugosllavisë.⁹⁵

Në kuadër të angazhimeve humanitare të SHBA-së duhet veçuar Operacionin “Sigurimi i strehës”/“Çkrahët e hapur” (“Open Arms”), në ndihmë të refugjatëve shqiptarë. Operacioni “Open Arms” ishte një përpjekje prej 100 milionë dollarësh për të transportuar 20 000 refugjatë kosovarë në Shtetet e Bashkuara derisa të ktheheshin në shtëpitë e tyre.⁹⁶ Kontributet e SHBA-së në Operacionin “Porti Aleat” (“Allied Harbor”) u koduan “Shining Hope” si dhe “Sustain Hope”. Gjatë 50 ditëve të para të funksionimit, *JTF “Shining Hope”* dërgoi më shumë se 3 400 tonë ushqim, pajisje dhe furnizime mjekësore për ata që kishin nevojë⁹⁷.

Gjatë gjithë Operacionit “Forca Aleate”, Shtetet e Bashkuara mbetën jashtëzakonisht të kujdesshme në lidhje me ndarjen e informacionit të ndjeshëm me aleatët e NATO-s. Amerikanët vendosën që informacioni për disa nga operacionet më të ndjeshme do të mbeten vetëm në SHBA. Një raport pretendon se Shtetet e Bashkuara e përjashtuan qëllimisht Francën nga qasja në planet tepër sekrete të NATO-s, për të reduktuar gjasat e rrjedhjeve të informacioneve në Beograd. Njëra nga arsyet ishte se në vitin 1998, një oficer francez në selinë e NATO-s ishte arrestuar për rrjedhje informacioni për planet e Aleancës në Kosovë dhe disa oficerë të tjerë francezë ishin akuzuar për vepra të ngjashme në të kaluarën.⁹⁸ Spiuni

⁹⁵ Daniel L. Haulman, “*The U.S. Air Force in the Air War Over Serbia, 1999*”, Air Power History / Summer 2015, Volume 62, Number 2, www.afhistoricalfoundation.org, 10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18; Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, 195-198, 218-220; Capt Gregory Ball, USAFR, Ph.D, 1999 - Operation Allied Force (<https://www.afhistory.af.mil/FAQs/Fact-Sheets/Article/458957/1999-operation-allied-force/>, qasja 15.08.2023; Operation Noble Anvil/ Operation Flexible Anvil/Operation Sky Anvi (<https://web.archive.org/web/20150506124419/http://www.globalsecurity.org/military/ops/noble-anvil.htm>, qasja 16.11.2023)

⁹⁶ <https://web.archive.org/web/20150901081623/>

<http://www.globalsecurity.org/military/ops/provide-refuge.htm>, qasja 16.11.2023)

⁹⁷ Operation Allied Harbour (OPLAN 10414)/Operation Sustain Hope/Shining Hope (<https://archive.ph/i5J7R#selection-917.0-882.79>, qasja 16.11.2023)

⁹⁸ John E. Peters&Stuart Johnson&Nora Bensahel&Timothy Liston&Traci Williams, *European Contributions to Operation Allied Force*, Project Air Force Rand, 2001, 39-41.

francez ishte majori Pierre-Henry Bunel, i cili për këtë veprim ishte dënuar me dy vjet heqje lirie. Pas lirimit nga burgu në vitin 1999, Bunel shkroi librin e tij “Krimet e luftës së NATO-s”, ku ai pretendon se kishte qenë viktimë e shërbimeve sekrete franceze.⁹⁹ Një raport zyrtar i administratës së Klintonit kishte pranuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar shpesh merrnin vendime pa u konsultuar me Francën, në mënyrë që të reduktonin mundësinë e rrjedhjeve (të informacioneve-M.K).¹⁰⁰ Gjatë operacionit, SHBA-ja u gjend në kundërshtim me aleatët e saj evropianë mbi taktikat. Së pari, çështja e një përshkallëzimi të luftës ajrore vuri përballë Shtetet e Bashkuara dhe Britaninë kundër Gjermanisë, Francës dhe aleatëve të tjerë evropianë. Së dyti, çështja e trupave tokësore ndanë qeverinë mbështetëse britanike nga pjesa tjetër e aleancës. Kështu, ruajtja e unitetit të NATO-s pati një çmim për politikën e Shteteve të Bashkuara. Aleatët evropianë ushtronin ndikim të konsiderueshëm në dimensionin taktik në përdorimin e forcës.¹⁰¹ Pavarësisht këtyre, SHBA-ja ishte dominuese në operacion. Dominimi i SHBA-së në fushën e kapaciteteve ushtarake të nevojshme për të kryer operacione ushtarake i mundësonte Uashingtonit, që me gjithë interesat e ndryshme individuale politike të aleatëve, përveç koncesioneve në nivel taktik, *kursin strategjik* të veprimit ta drejtonte në përputhje me dëshirat dhe interesat e veta. Duket se kjo kishte shkaktuar pakënaqësi të madhe në mesin e aleatëve, veçanërisht të Francës.¹⁰²

Përmbledhur me pak fjalë. Kryesimi i NATO-s nga SHBA-ja në OFA-n, përdorimi më i madh i forcave ajrore, detare dhe tokësore;

⁹⁹ Ksenofon Krisafi, *Lufta e Kosovës dhe labirintet diplomatike*, UMSH Press&Onufri, Tiranë, 2018, 168, 169.

¹⁰⁰ John E. Peters&Stuart Johnson&Nora Bensahel&Timothy Liston&Traci Williams, *European Contributions to Operation Allied Force*, Project Air Force Rand, 2001, 39-41.

¹⁰¹ Dissertation zur Erlangung des Doktorgrades (Dr. rer. pol.), Alliance Politics Under Unipolarity European Influence on Transatlantic Military Interventions, Freie Universität Berlin, Fachbereich Politik- und Sozialwissenschaften, Otto-Suhr-Institut für Politikwissenschaft, Pia Fuhrhop, Berlin, März 2014, 122, 123, 124, 125.

¹⁰² Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, 242-265.

të pajisjeve; kontribuesi më i madh në aspektin furnizues; vendosja e shumicës së avionëve në operacionet ajrore kundër Serbisë, më shumë se 700 avionë nga gjithsej 1 055; numri më i madh i fluturimeve, sulmeve dhe mbështetjes etj., e bëjnë SHBA-në lider të pakontestueshëm edhe në OFA. Shtetet e Bashkuara shpërndanë gjithashtu numrin më të madh të PGM-ve, JDAM, ISOW, Paveway II dhe III, Maverick, AGM-130, raketa lundrimi të lëshuara nga ajri dhe deti si dhe armë të tjera të drejtuara u lëshuan të gjitha gjatë OFA-s. Duke pasur parasysh Rregullat Kufizuese të Angazhimit (ROE) dhe kushtet e motit, këto armë shumë të sakta u treguan të domosdoshme. Shtetet e Bashkuara siguruan mbi 90 për qind të AAR-së dhe të gjitha aftësitë e bllokimit taktik për misionin SEAD. SHBA-ja, gjithashtu, siguroi pjesën më të madhe të aftësive të transportit ajror për OFA me C-17 dhe C-130.¹⁰³ Lufta ajrore e NATO-s ishte përpjekje dërmuese e SHBA-së. SHBA-ja kreu mbi 80% të fluturimeve, mbi 90% të misioneve të luftës elektronike, gjuajti mbi 80% të armëve ajrore të drejtuara dhe nisi mbi 95% të raketave Cruise.¹⁰⁴ Beretat e Gjelbra amerikane stërvitën dhe pajisën në mënyrë të fshehtë forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) para dhe gjatë Operacionit “Forca Aleate” në vitin 1999.¹⁰⁵ Një kontribut të veçantë dhe historik për OFA-n ka dhënë edhe shtypi amerikan,¹⁰⁶ me theks të veçantë: *Washington Post*, *New York Times*, *Wall Street Journal*, *Los Angeles Times* etj.

Mbretëria e Bashkuar¹⁰⁷ është njëra nga shtetet themeluese të NATO-s.¹⁰⁸ Publikime të ndryshme britanike flasin për qëndrimin dhe

¹⁰³ John E. Peters&Stuart Johnson&Nora Bensahel&Timothy Liston&Traci Williams, *European Contributions to Operation Allied Force*, Projekt Air Force, Rand, 2001, 23, 24.

¹⁰⁴ John E. Peters & Stuart Johnson & Nora Bensahel & Timothy Liston & Traci Williams, *European Contributions to Operation Allied Force*, Projekt Air Force, Rand, 2001, 24.

¹⁰⁵ Daniele Ganser, *Gladio shërbimi sekret i NATO-s 1949-2001* (shqipëruar nga Ilir Krasniqi), Helga's Secrets, pa vit botimi, 105.

¹⁰⁶ Hajrudin S.Muja, *Lufta e Kosovës në shtypin amerikan 28 shkurt 1998-10 qershor 1999*, Logos-A. Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2012.

¹⁰⁷ Philippe Chassaigne, *Historia e Anglisë, (përktheu: Asti Papa), SHB “Dituria”, Tiranë, 2015.*

kontributin e Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën në aspektin politik, diplomatik, ushtarak, humanitar¹⁰⁹ dhe mediatik.¹¹⁰ Britanikët, si edhe amerikanët, kanë dhënë kontribut të veçantë në kuadër të NATO-s, në operacionet e kësaj organizate, duke përfshirë edhe OFA-n. Britanikët dhe amerikanët ishin partner të ngushtë politikë.¹¹¹

Gjatë shfletimit të dokumenteve të deklasifikuara dhe publikimeve të tjera, një pjesë e të cilave janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe, shihet një koordinim i punëve mes britanikëve dhe amerikanëve, me theks të veçantë bien në sy takimet dhe bisedat e shpeshta (telefonike) të kryeministrit britanik, Tony Blair, me presidentin amerikan, Klinton, që nga muaji korrik, gusht, tetor dhe nëntor 1998, por edhe në janar, shkurt, mars, prill, maj e qershor 1999.¹¹² Siç shkruan në librin e tij “Një rrugëtim”, kryeministri Tony Blair, punonte me dy grupe, me amerikanët dhe evropianët.¹¹³ Sipas Shefit të Shtabit të Përbashkët të Operacionit “Forca Aleate”, admirali Sir Ian Garnett, Mbretëria e Bashkuar kishte siguruar forca të konsiderueshme ajrore, tokësore dhe detare.¹¹⁴ Në fushën ushtarake, që nga 4 tetori, Mbretëria e Bashkuar njoftoi vendosjen e katër avionëve sulmues RAF Harrier GR-7 në bazën ajrore të Gioia del

¹⁰⁸ The United Kingdom and NATO

(https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_162351.htm, qasja 14.02.23)

¹⁰⁹ British Army Review, Special Report - The Yugoslav Wars, Spring 2020, 207, 208, 209, 210, 212, 215 <https://www.army.mod.uk/media/9103/bar-report-yugoslav-wars.pdf>, qasja 04.09.2022).

¹¹⁰ Shyqri Nimani, *78 ditë bombardime të NATO-s sipas gazetave brotanike*, Ars Albanica, Prishtinë, 2021; Marc Lynton Latham, *British Media Coverage of the Kosovo Conflict*, Submitted in accordance with the requirements for the degree of PhD, The University of Leeds Institute of Communications Studies March, 2005

(https://etheses.whiterose.ac.uk/683/1/uk_bl_ethos_422635.pdf, qasja e fundit 25.08.2024)

¹¹¹ Tony Blair, *Një rrugëtim*, SHB 55, Tiranë, 2011, 279.

¹¹² Marc Perry, *Lufta me fjalët e tyre*, Koha, Prishtinë, 2023, 20-24, 32-39, 48-55, 58-63, 64-67, 68-75, 85-89, 90-97, 128-143, 144-150.

¹¹³ Tony Blair, *Një rrugëtim*, SHB 55, Tiranë, 2011, 274-279.

¹¹⁴ Tim Youngs, Mark Oakes and Paul Bowers, *Kosovo: Operation “Allied Force”*, INTERNATIONAL AFFAIRS & DEFENCE SECTION, Mick Hillyard, ECONOMIC POLICY & STATISTICS SECTION, HOUSE OF COMMONS LIBRARY, RESEARCH PAPER 99/48 29 APRIL 1999, 61, qasja 15.12.2022.

Colle në Itali.¹¹⁵ Më 7 dhjetor 1998, personeli i parë i Mbretërisë së Bashkuar u vendos në Maqedoni për t'iu bashkuar Operacionit “Forca Nxjerrëse”.¹¹⁶ Personeli i parë i Mbretërisë së Bashkuar në “Forcën Nxjerrëse” vendoset në Maqedoni për Nivelin 1 të EF.¹¹⁷ Në kontekst të situatës në Kosovë, që nga 6 marsi 1999, britanikët fillojnë të vendosin në Maqedoni elementë të Korpusit të Reagimit të Shpejtë të Komandës Aleate për Evropën (ARRC), të komanduar nga gjenerali britanik Mike Jackson. Ata do të formonin një element komandimi dhe kontrolli të NATO-s për të bashkërenduar forcat e NATO-s tashmë të pranishme.¹¹⁸ Më 15 mars, sekretari i Mbrojtjes pranon devijimin e *HMS Splendid* (nëndetësja e parë RN me aftësi TLAM) në Adriatik për operacione të mundshme kundër RFJ-së.¹¹⁹ Kontributi i Mbretërisë së Bashkuar për Operacionin “Garantuesi i vendosur” përbëhej nga 390 personel nga Regjimenti Kufitar Mbretëror i Batalionit të Parë të Mbretit me 14 automjete të blinduara luftarake. Ata mbështeteshin nga rreth 250 inxhinierë mbretërorë, specialistë sinjalizues dhe anëtarë të Korpusit Logjistik Mbretëror. Kontributi i Mbretërisë së Bashkuar (kodi i quajtur Operacioni “Agricola”) numëron rreth 3 020 personel me një kontribut total të vendosur në rreth 8 000.¹²⁰ Kontributi i Britanisë si pjesë e Operacionit “Eagle

¹¹⁵ Tim Youngs, Kosovo: *The Diplomatic and Military Options*, International Affairs and Defence Section, House of Commons Library, Research paper 98/93, 27 october 1998, 26, 27.

¹¹⁶ House of Commons, Defence - Fourteenth Report, Session 1999-2000, Publications on the internet, Defence Committee Publications, to be printed 23 October 2000, <https://publications.parliament.uk/pa/cm199900/cmselect/cmdfence/347/34702.htm>, qasja 15.12.2022.

¹¹⁷ <https://publications.parliament.uk/pa/cm199900/cmselect/cmcaff/28/9111806.htm>, qasja 19.12.2022.

¹¹⁸ Tim Youngs, Kosovo: *The Diplomatic and Military Options*, International Affairs and Defence Section, House of Commons Library, Research paper 99/34 24 March 1999, 51, 52, 53, 54, 55.

¹¹⁹ <https://publications.parliament.uk/pa/cm199900/cmselect/cmcaff/28/9111807.htm>, qasja 19.12.2022.

¹²⁰ Tim Youngs, Kosovo: *The Diplomatic and Military Options*, International Affairs and Defence Section, House of Commons Library, Research paper 99/34 24 MARCH 1999, 2 1, 23, 51, 52, 53, 54, 55.

Eye” (“Syri i Shqiponjës”) ishte një avion zbulues Canberra PR9, me bazë në Gioia del Colle (Itali).¹²¹

Sipas të dhënave të publikuara pas përfundimit të OFA-s nga Ministria e Mbrojtjes, këto njësi të Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar, ose elementë të tyre, u dislokuan në IRJM dhe Kosovë gjatë viteve 1998-1999 si pjesë e “Forcës Nxjerrëse” dhe dislokimit fillestar të KFOR-it. *Shtabi*: Korpusi i Komandës Aleate për Evropën i Reagimit të Shpejtë, Shtabi i Divizionit të 3-të të Mbretërisë së Bashkuar dhe Regjimenti i Sinjalit, Shtabi i Brigadës 4 të Blinduar dhe Skuadrilja Sinjalizuese, Shtabi i Brigadës 5 Ajrore dhe Skuadrilja e Sinjalit dhe Shtabi i Brigadës 101 Logjistike dhe Skuadrilja e Sinjalit. Njësi u dislokuan edhe nga Korpusi i Blinduar Mbretëror, nga Korpusi i Inxhinierëve Mbretërorë, nga Korpusi Mbretëror i Sinjaleve. U dislokuan edhe njësi të Këmbësorisë, njësi nga Korpusi Ajror i Ushtrisë, nga Korpusi Mbretëror i Logjistikës, nga Korpusi Mjekësor i Ushtrisë Mbretërore, Inxhinierët Mbretërorë Elektrikë dhe Mekanikë, Policia Ushtarake Mbretërore si dhe Grupi i Shtabit 1.¹²² Nga pajisjet tokësore përmenden 28 tankse, 12 AS-90 (Howitze); automjete luftarake: 20 automjete të blinduara dhe automjete tjera luftarake. Personeli: 6300 në Maqedoni. Të gjitha forcat britanike dhe ato të aleatëve të tjerë ishin nën kontrollin operacional të gjeneralit Sir Mike Jackson. Në fakt forcat e NATO-s të vendosura në Maqedoni njiheshin me emrin KFOR, kurse “Operacioni Agrícola” është

¹²¹ Operation Eagle Eye Operation Joint Guarantor / Determined Guarantor (https://web.archive.org/web/20150901081656/http://www.globalsecurity.org/military/ops/eagle_eye.htm, qasja 16.11.2023); Tim Youngs, Kosovo: *The Diplomatic and Military Options*, International Affairs and Defence Section, House of Commons Library, Research paper 99/48 29 APRIL 1999, 20, qasja 15.12.2023.

¹²² Ministry of Defence, *Kosovo: Lessons from the Crisis*, Annex C: UK Army units deployed, Presented to Parliament by the Secretary of State for Defence by Command of Her Majesty - June 2000, Annex C, Archived On 9 Jan 2006, 80-84 (https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20060109125124/http://www.mod.uk/publications/kosovo_lessons/contents.htm, pdf, qasja 5.01.2023)

kontributi i MB-së për KFOR-in.¹²³ Nga asetet detare britanike të dislokuara ndër të tjera përmenden: 1 aeroplanmbajtëse, 2 nëndetëse, 2 fregata, 1 shkatërrues Newcastle, 2 flota ndihmëse.¹²⁴

Lidhur me të dhënat statistikore dhe me kontributin britanik janë konsultuar së paku dy të dhëna britanike. E dhëna e parë thotë se Mbretëria e Bashkuar (MB) kontribuoi me 48 avionë me krahë fiks në Operacionin Forca Aleate, megjithëse jo të gjithë ishin në teatër në të njëjtën kohë.¹²⁵ E dhëna e dytë thotë se në Operacionin “Forca Aleate”, Britania mori pjesë në operacion me 56 avionë.¹²⁶ Nëse numri i përgjithshëm i fluturimeve të NATO-s ishte 38 004, atëherë numri i përgjithshëm i sulmeve të NATO-s ishte 10 484, ndërkaq numri i përgjithshëm i fluturimeve nga Mbretëria e Bashkuar del të jetë 1 618. Totali i Mbretërisë së Bashkuar përbëhet nga: llojet e goditjes - GR1 dhe GR7 (1008), patrulla ajrore luftarake - FA2 (102), paralajmërimi i hershëm në ajër - E3D (184), furnizimi me karburant nga ajër në ajër - Tristar dhe VC 10 (324).¹²⁷ Nëse një total prej 1 618 fluturimesh u kryen nga avionët e Mbretërisë së Bashkuar gjatë Operacionit “Forca Aleate”, atëherë nga këto, 1 008 ishin sulme që çuan në lëshimin e 1 011 municioneve; 244 ishin armë të drejtuara me saktësi, 230 ishin bomba graviteti dhe 531 ishin armë thërrmuese. Për më tepër, u lëshuan gjashtë raketa anti-rrezatuese të lëshuara nga ajri.

¹²³ Tim Youngs, Kosovo: *The Diplomatic and Military Options*, International Affairs and Defence Section, House of Commons Library, Research paper 99/48 29 APRIL 1999, 62, 63, 70, 77, qasja 15.12.2022.

¹²⁴ Tim Youngs, Mark Oakes and Paul Bowers, *Kosovo: Operation “Allied Force”*, International Affairs & Defence Section, Mick Hillyard, Economic Policy & Statistics Section, House of Commons Library, Research Paper 99/48 29 APRIL 1999, 62, 63, 70, 77, qasja 15.12.2022.

¹²⁵ House of Commons, Defence - Fourteenth Report, Session 1999-2000, Publications on the internet, Defence Committee Publications, to be printed 23 October 2000 (<https://publications.parliament.uk/pa/cm/199900/cmselect/cmdfence/347/34702.htm>), qasja 15.12.2022).

¹²⁶ Dr Sebastian Ritchie, *The Royal Air Force and UK Air Power over Iraq and Kosovo, 1997-2000*, UK MOD Crown Copyright, 2021, 244.

¹²⁷ Ministry of Defence, *Kosovo: Lessons from the Crisis*, Annex F: UK Army units deployed, Presented to Parliament by the Secretary of State for Defence by Command of Her Majesty - June 2000, Archived On 9 Jan 2006, 87.

Referuar burimeve britanike, por jo vetëm, shihet se Britania e Madhe ofroi më pak avionë sesa francezët dhe italianët. Numri i municioneve të hedhura nga avionët e Mbretërisë së Bashkuar për çdo fluturim goditës ishte dukshëm më i ulët se mesatarja e NATO-s. RAF kreu 9.6% të sulmeve të NATO-s, por hodhi vetëm 4.2% të municioneve. Pjesërisht kjo ishte për shkak të motit të keq që ndikonte në përdorimin e municioneve të drejtuara me saktësi.¹²⁸

Sipas Ministrisë së Mbrojtjes britanike, numri i përgjithshëm i municioneve ajrore të lëshuara nga avionët e NATO-s ishte 23 614, kurse numri i përgjithshëm i municioneve ajrore të lëshuara nga avionët e Mbretërisë së Bashkuar ishte 1 011.¹²⁹ Gjatë Operacionit Forca Aleate, RAF dorëzoi 244 municione të drejtuara me saktësi dhe 761 bomba graviteti (“memecë”). Nga këto të fundit, 230 ishin bomba 1 000 lb dhe 531 ishin armë thërrmuese. 20 raketa lundrimi TLAM u hodhën nga HMS *Splendid*. Përveç këtyre, janë lëshuar 6 raketa anti-rrezatuese ALARM. Mesatarisht 12.8 bomba ose raketa u dorëzuan nga MB çdo ditë të fushatës, me një kulm prej 63 më 3 maj 1999.¹³⁰

Në aspektin humanitar, Britania është kujdesur dhe ka dhënë një kontribut të madh edhe në transportin ajror të financuar nga DFID, edhe në Operacionin “Porti Aleat” (“Aleat Harbour”) në Shqipëri, i cili komandohej nga gjenerallejtnant John Reith dhe në qendër të saj ishte selia e Forcave Lëvizëse të Komandës Aleate në Evropë (Toka) – AMF (L). Rreth 1 500 personel në MB do të vendosen në AFOR si

¹²⁸ House of Commons, Defence - Fourteenth Report, Session 1999-2000, Publications on the internet, Defence Committee Publications, to be printed 23 October 2000 (<https://publications.parliament.uk/pa/cm/199900/cmselect/cmdfence/347/34702.htm>, qasja 15.12.2022)

¹²⁹ Ministry of Defence, *Kosovo: Lessons from the Crisis*, Annex F: UK Army units deployed, Presented to Parliament by the Secretary of State for Defence by Command of Her Majesty - June 2000, përditësimi i fundit: 5 shtator 01, p.87.

¹³⁰ House of Commons, Defence - Fourteenth Report, Session 1999-2000, Publications on the internet, Defence Committee Publications, to be printed 23 October 2000 (<https://publications.parliament.uk/pa/cm/199900/cmselect/cmdfence/347/34702.htm>, qasja 15.12.2022).

pjesë e AMF(L). Kontributi i MB-së përfshin një grup batalioni këmbësorie, një batalion logjistik dhe një skuadron sinjalesh.¹³¹

Në aspektin politik e diplomatik dhe të perceptimit, Britania shpesh kryeson, merr primarin e liderit, sidomos në nivelin evropian. Në aspektin ushtarak Britania futet në pesëshen e madhe për kontribut në operacion. Qeveria britanike ishte çuditërisht e izoluar në *debatin strategjik* të NATO-s për Kosovën.¹³² Për sa i përket pjesës së qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar në formulimin e strategjisë së NATO-s, është thelbësore të kuptohet se, siç shprehen nga Ministria e Mbrojtjes, Këshilli i Atlantikut të Veriut përcaktoi parametrat dhe objektivat politike për fushatën, dha udhëzime për Autoritetet Ushtarake të NATO-s dhe mbikëqyri aktivitetet e tyre, të ndihmuara nga Komiteti Ushtarak. Në fakt, Mbretëria e Bashkuar mund të kërkonte të ndikojë në strategjinë, por, në fund të fundit, nuk mund ta diktonte atë¹³³. Në nivelin operacional, kontributi sulmues i RAF-it gjatë OFA-s mund të konsiderohet një sukses për aq sa kontribuoi drejtpërdrejt në arritjen e objektivit të NATO-s që ishte tërheqja e forcave të RFJ-së nga Kosova. Në nivelin taktik, vlerësimi i suksesit në fushatë duket se është matur po aq sa i përket përpjekjeve të shpenzuara si rezultate të arritura.¹³⁴

¹³¹ Tim Youngs, Mark Oakes and Paul Bowers, *Kosovo: Operation "Allied Force"*, International Affairs & Defence Section, Mick Hillyard, Economic Policy & Statistics Section, House of Commons Library, Research Paper 99/48 29 April 1999, 63, 64, 80, qasja 15.12.2022.

¹³² Më gjerësisht shih Dr. Sebastian Ritchie, *The Royal Air Force and UK Air Power over Iraq and Kosovo, 1997-2000*, UK MOD Crown Copyright, 2021, 2 16-226, 244.

¹³³ *House of Commons*, Defence - Fourteenth Report, Session 1999-2000, Publications on the internet, Defence Committee Publications, to be printed 23 October 2000 (<https://publications.parliament.uk/pa/cm/199900/cmselect/cmdfence/347/34702.htm>), qasja 15.12.2022).

¹³⁴ Më gjerësisht shih Dr. Sebastian Ritchie, *The Royal Air Force and UK Air Power over Iraq and Kosovo, 1997-2000*, UK MOD Crown Copyright, 2021, 214-226, 244.

Franca¹³⁵ si anëtare e NATO-s që nga themelimi,¹³⁶ është e përfshirë ngushtë në operacione të NATO-s (duke përfshirë edhe Operacionin “Forca Aleate”), pavarësisht të ndonjë mosmarrëveshjeje brenda Aleancës.¹³⁷ Kur më 24 mars 1999, NATO-ja i shpalli luftë Serbisë, me vendim të presidentit të Republikës, Jacques Chirac, dhe në marrëveshje me Qeverinë, Franca iu bashkëngjiti aleatëve në fushatën ajrore kundër Serbisë.¹³⁸ Për nga kontributi ushtarak në OFA, Franca ishte e para në nivel evropian, kurse e dyta në NATO, menjëherë pas SHBA-së. Sistemi ushtarak francez përbante dy komponentë të veçantë: misionet ajrore (në kuadër të Operacionit “Forca Aleate”) dhe prania tokësore në Shqipëri dhe Maqedoni. Në komponentin e parë, në misionet ajrore në Republikën Federative të Jugosllavisë, Franca, nga 24 marsi 1999, mori pjesë me avionët e saj që i përkisnin forcës ajrore dhe marinës, të cilët operonin nga Italia, aeroplanmbajtësi *Foch* dhe territori kombëtar.¹³⁹ Komponenta e dytë e angazhimit ushtarak francez kishte të bënte me praninë franceze në Shqipëri dhe Maqedoni: kjo ishte plotësisht e orientuar drejt mbështetjes së veprimeve humanitare.¹⁴⁰

Angazhimi i Ushtrisë franceze filloi me dërgimin dhe vendosjen e 500 ushtarëve në Kumanovë të Maqedonisë, më 7 dhjetor 1998. Në shkurt numri u rrit në 1 160, kurse në mes të marsit 1999 numri u rrit në 2 340 ushtarë, duke arritur formatin e një brigade. Brigada përbëhej nga dy batalione dhe komandohej nga gjenerali Valentin.¹⁴¹ Francezët kryenin aktivitete të përbashkëta me anglezët në

¹³⁵ Georges Duby, *Historia e Francës* (përkthyer: Asti Papa, Nasi Lera, Sokol, Haxhimusai, Ardian Vehbiu), SHB “Dituria”, Tiranë, 2012

¹³⁶ France and NATO (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_160672.htm, qasja 28.08.2023).

¹³⁷ Maurice Vaïsse, Clémence Sebag, *France and NATO: An History*, Dans Politique étrangère 2009/5 (Hors série), 139 à 150 ()

¹³⁸ *Le Monde*, 25/03/1999, 1; BAUDOUIN 2018: 230.

¹³⁹ <https://www.vie-publique.fr/discours/183194-declaration-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-en-reponse-des-ques>, qasja 05.04.1999.

¹⁴⁰ <https://www.vie-publique.fr/discours/177710-declarations-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-sur-la-situation-au>, qasja, 4.04.2021.

¹⁴¹ Assemblée Nationale - Séance du 04/12/1999 : N° 2022. *Raport i informacionit nga*

kampet maqedonase të pritjes, me italianët dhe me gjermanët në Shqipëri.¹⁴² Duke qenë pjesë e Operacionit “Streha Aleate”, francezët morën edhe drejtimin e Task Forcës Jugore në Jugun e Shqipërisë (Elbasan, Korçë, Fier dhe Gramsh). Baza e tyre ishte vendosur në Elbasan dhe vepronte nën urdhrat e kolonelit Gros. Përbëhej nga një batalion me 900 ushtarë francezë, afërsisht 167 grekë, 100 nga Danimarka dhe 48 nga Emiratet. Personeli i batalionit ishte angazhuar në krijimin e kushteve të përshtatshme për strehimin e refugjatëve dhe për shpërndarjen e ndihmave humanitare. Kujdesej për ndërtimin e kampeve të reja, duke marrë parasysh madje edhe stilin e jetës së refugjatëve, duke rikrijuar një atmosferë fshati (shtegu, vendet, pikat e takimit, parkimin e traktorëve etj.) në mënyrë që të bëjnë mjedisin e tyre më njerëzor.¹⁴³ Në aspektin humanitar ishte angazhuar personalisht edhe presidenti Zhak Shirak.¹⁴⁴

Në aspektin ushtarak, siç e thashë edhe në fillim, shteti i Francës ishte kontribuesi i dytë më i madh i Aleancës pas Shteteve të Bashkuara dhe partneri i parë evropian në Operacionin “Forca Aleate”. Nga një total prej 786 avionësh të Aleancës të përfshirë në operacione, prej tyre 98 ishin nga ky shtet. Në kulmin e përfshirjes francezët aktivizuan gati 10% të kapacitetit ajror (krahasuar me 5.3% në Itali, 4.8% në Mbretërinë e Bashkuar dhe 2.1% në Gjermani) dhe

Komisioni i Mbrojtjes Kombëtare dhe Forcave të Armatosura në Asamblenë Kombëtare prezantuar nga MM Paul QUILÈS dhe François LAMY, 15 dhjetor 1999, Données originales sur: <https://www.assemblee-nationale.fr/legislatures/11/pdf/rap-info/i2022.pdf>, mise à jour du 13.04.2021; Déclaration de M. Lionel Jospin, Premier ministre, en réponse à des questions sur la situation au Kosovo, notamment les dimensions militaire, humanitaire et diplomatique de l'engagement des Alliés après quatre semaines de conflit, à l'Assemblée nationale le 13 avril 1999. Données originales sur: <https://www.vie-publique.fr/discours/183194-declaration-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-en-reponse-des-ques>, mise à jour du 05/04/2021.

¹⁴² Déclaration de M. Lionel Jospin, Premier ministre, en réponse à des questions sur la situation au Kosovo, notamment le règlement politique de la crise, l'aide engagée en faveur des réfugiés en Albanie et en Macédoine et la mobilisation de l'Union européenne dans le cadre de la reconstruction et du développement des Etats de la région, au Sénat le 15 avril 1999. Données originales sur: <https://www.vie-publique.fr/discours/185349-declaration-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-en-reponse-des-ques>, mise à jour du 05/04/2021).

¹⁴³ Reliefweb 18/08/2000.

¹⁴⁴ Po aty

kryen 12-13% të misioneve sulmuese, 20% të misioneve të inteligjencës, por vetëm 8% të misioneve të mbrojtjes ajrore. Po ashtu, u kryen midis 1 263 dhe 1 675 misione bombardimesh. Në misione ishin angazhuar këto lloje aeroplanësh (avionësh): Mirage 2000 D, Mirage F1CT, Jaguar, Super Etendard; Mirage 2000 RDI; Mirage IVP, Mirage F1 CR, Etendard IVP, Alizé; AWACS, Refueller C 135 FR.¹⁴⁵ Numri i aeroplanëve bombardues ndryshoi varësisht nga periudha. Nga 24 mars deri më 10 qershor, flota e avionëve të Forcave Ajrore realizoi gati 2 000 misione përfshirë 851 misione bombardimesh, 476 misione të mbrojtjes ajrore, 149 misione zbulimi, 112 misione të inteligjencës elektronike dhe 320 karburante gjatë fluturimit.¹⁴⁶ Kontribut i madh nga francezët u dha në misionet e transportit dhe mbështetjes (21.8%), në misionet e zbulimit (20.2%) dhe në misionet sulmuese (12,8%).¹⁴⁷ Është vlerësuar se 41% e misioneve u anuluan gjatë fluturimit (431 për Forcën Ajrore dhe 88 për Marinën) për arsye meteorologjike ose të lidhura me kufizimet e vendosura për pilotët për të qëlluar vetëm në objektivat e identifikuar. *Forcat detare franceze* angazhuan edhe disa anije franceze. *Grupi francez* i transportuesve, që përbën *Task Force 470*, u vendos nga 27 janari 1999, dita e nisjes nga Toulon, deri më 3 qershor, dita e kthimit të saj. Ai përfshinte aeroplanmbajtësen *Foch*, dy fregata, njëra anti-ajrore, tjetra anti-nëndetëse (së pari *Montcalm* dhe *Surcouf*, pastaj *Cassard* dhe *Tourville*), anijen furnizuese *Meuse*. *Grupi i goditjes* përfshiu gjithashtu një nëndetëse sulmi bërthamor, një tjetër instrument i fuqisë. Në qershor, tri anije operuan në teatër, fregata anti-nëndetëse *La Motte Picquet* dhe dy anijet e uljes transportojnë TCD *Orange* dhe *Sirocco* për instalimin e elementeve të KFOR-it.¹⁴⁸ Francezët së bashku me britanikët ishin ndër aleatët e paktë evropianë që zotëruan dhe përdorën municione të drejtuara me saktësi (PGM). Shumica e PGM-ve të përdorura nga francezët ishin bomba të

¹⁴⁵ Assemblée Nationale - Séance du 04/12/1999.

¹⁴⁶ <https://www.assemblee-nationale.fr/rap-info/i1775.asp>, qasja 13.04.2021

¹⁴⁷ Déclaration de M. Lionel Jospin, 13/04/1999.

¹⁴⁸ <https://www.assemblee-nationale.fr/rap-info/i1775.asp>, qasja 13.04.2021.

drejtuar me lazer Paveway II dhe III, megjithëse ata gjithashtu gjuanin disa AS301 raketa ajër-tokë.¹⁴⁹ Pavarësisht nga kontributi i madh që ka dhënë Franca në Operacionin “Forca Aleate”, ka pasur raste kur ka qenë e përmbajtur, ka pasur raste kur ka luajtur rolin e skeptikut, por edhe ka pasur raste kur ka kundërshtuar ashpër goditjen e disa shënjestrave (cageve) strategjike ushtarake serbe. Njohësit e mirë të kësaj çështjeje thonë se fuqia e vetos së Francës ishte një nga kodikujt e pashkruar të Planit të Operacionit 10601, plani ushtarak për Operacionin “Forca Aleate”.¹⁵⁰ Edhe Komandanti i Forcave Aleate, gjenerali W. Klark pohon se kishte problem për të siguruar pëlqimin e francezëve për të qëlluar në zemër sistemin serb për komunikim, i cili zakonisht ishte i vendosur në qendër të shumicës së qyteteve, duke ngritur në mënyrë substanciale rrezikun për civilët që gjendeshin aty afër.¹⁵¹ Megjithatë, objektivi i vetëm që francezët refuzuan të lejonin sulmin e NATO-s ishte e ashtuquajtura ura *Rock ‘n’ Roll* mbi lumin Sava në Beograd, ku një numër i madh vullnetarësh serbë qëndronin si mburoja njerëzore.¹⁵² Mediet (shtypi dhe televizioni) gjithashtu ishin vënë në funksion, në shërbim të paqes dhe lirisë, kundër mizorive dhe barbarisë. Pothuajse janë të përditshëm artikujt në shtypin francez për luftën në Kosovë më konkretisht për operacionin. Janë bërë edhe studime dhe analiza për rolin e medias franceze për luftën e Kosovës.¹⁵³ Në përkrahje të operacionit ishte edhe opinionin publik

¹⁴⁹ John E.Peters, Stuart Johnson, Nora Bensahel, Timothy Liston, Traci Williams, *European Contributions to Operation Allied Force*, Projekt AIR FORCE, RAND, 2001, 18, 20, 21.

¹⁵⁰ Dana Priest, “*France Played Skeptic on Kosovo Attacks*”, Washington Post, Monday, September 20, 1999; Page A1.

¹⁵¹ Gjeneral Wesley K.Clark, *Të bësh luftë moderne*, Artini, Prishtinë, 2022, 317, 343.

¹⁵² Dana Priest, “*France Played Skeptic on Kosovo Attacks*”, Washington Post, Monday, September 20, 1999; Page A1.

¹⁵³ Par Nicolas Pélissier, *L’information en guerre: les médias français et le conflit du Kosovo*, /pdf/p.207-223, qasja 29.06.2023; Éric Maigret, « Le conflit du Kosovo du côté des opinions », Questions de communication [En ligne], 1 | 2002, mis en ligne le 01 mars 2002, consulté le 01 mai

2019; URL:<http://journals.openedition.org/questionsdecommunication/6497>; DOI:10.4000/questionsdecommunication.6497, qasja 29.06.2023; Renaud de La Brosse, La couverture

francez.¹⁵⁴ Me pjesëmarrjen e Francës në Operacionin “Forca Aleate”, NATO-ja dëshmon se arriti të ruajë kohezionin, pavarësisht se kishte pikëpamje të ndryshme mes aleatëve, sidomos sa i përket objektivave (shënjestrave) që duhej të sulmoheshin. Pjesëmarrja e Francës në operacion ishte një argument më shumë se ishte Serbia ajo që kishte detyruar madje edhe miqtë e saj tradicional ta sulmonin, sepse nuk kishte respektuar asnjërën nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kishte shkelur marrëveshjet e arritura dhe kishte kundërshtuar edhe arritjen e Marrëveshjes së Rambujesë si dhe vazhdonte me spastrim etnik. Mirëpo, këto nuk ishin arsytet e vetme pse Franca mori pjesë në OFA. Duhet përmendur me këtë rast edhe faktin se me pjesëmarrjen e saj në operacion, Franca po faktorizohej edhe në kuadër të NATO-s, sepse Franca bëri një hap të madh drejt integritimit në strukturën e integruar ushtarake të NATO-s nga e cila ishte larguar në vitin 1966, por u kthye në vitin 2009. Me fjalë të tjera, edhe Franca si edhe shtetet e tjera, me pjesëmarrjen në fushatën ajrore të NATO-s kishin interesa politike, ushtarake dhe strategjike. Kësisoj, Franca duke e shfrytëzuar rastin e Kosovës, u faktorizua edhe më shumë si fuqi ndërkombëtare, kurse Kosova e fitoi lirinë duke pasur edhe mbështetjen e Francës, kontributi ushtarak i të cilës ishte i madh.

Gjermania¹⁵⁵ iu bashkua NATO-s më 9 maj 1955¹⁵⁶. Ajo iu bashkua edhe përpjekjeve të faktorit ndërkombëtar për të kontribuar për çështjen e Kosovës. Në bazë të disa raporteve, Gjermania përpigjej që ta shtynte opinionin evropian në një drejtim më përkrahës për Kosovën shumë para fillimit të Operacionit “Forca Aleate”.¹⁵⁷

médiatique de la guerre du Kosovo ou le journalisme impossible, Les Cahiers du journalisme n o 7 - Juin 2000, p.196-210/pdf, qasja 29.06.2023.

¹⁵⁴ https://www.ifop.com/ép-content/uploads/2018/03/556-1-document_file.pdf ; <https://www.ipsos.com/fr-fr/la-guerre-en-yougoslavie-les-francais-pris-par-le-doute>, qasja 21.09.2023., qasja 21.09.2023.

¹⁵⁵ Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 2006, 445-447.

¹⁵⁶ Germany and NATO (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_185912.htm), qasja 28.08.2023).

¹⁵⁷ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Onufri, Tiranë, 2013, 186, 190.

Pjesëmarrja ushtarake gjermane në Operacionin “Forca Aleate” të NATO-s përfaqëson herën e parë që nga Lufta e Dytë Botërore.¹⁵⁸

Bundeswehr-i ishte i përfshirë në të gjitha misionet që kishin të bënin me çështjen e Kosovës.¹⁵⁹ Kur më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Solana, dha urdhrin operacional për fillimin e Operacionit “Forca Aleate”, Gjermania e mbështeti këtë vendim dhe mori pjesë në zbatimin e tij.¹⁶⁰ Fillimi i Operacionit (më 24 mars 1999) e gjeti Gjermaninë për herë të parë pjesë të operacionit bashkërisht dhe në të njëjtin nivel me amerikanët, britanikët, partnerët francezë dhe të tjerë, për të kryer sulme ajrore. Në kuadrin e operacioneve ajrore nga 24 mars 1999 deri në pezullimin e operacioneve ajrore më 10 qershor 1999, *Luftwaffe* (forca ajrore) kreu pothuajse 500 misione me 14 Tornadot e saj, gjatë të cilave u lëshuan më shumë se 200 raketa HARM.¹⁶¹ *Luftwaffe* gjermane luajti një rol të rëndësishëm në operacionet ajrore, duke kryer 636 fluturime, kryesisht në mbështetje të shtypjes së misionit të mbrojtjes ajrore të armikut (SEAD). Gjermanët vendosën 14 Tornado për të mbështetur Operacionin, dhjetë prej të cilave ishin Tornado elektronike luftarake dhe zbulimi (ECR) dhe katër ishin Tornado ndaluese dhe goditëse të pajisura me mjete zbulimi. Tornado ECR u përdor gjerësisht për të shtypur mbrojtjen ajrore të armikut, ndërsa katër Tornado tjera u

¹⁵⁸ CRS Report for Congress, *Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes*, Karen Donfried (coordinator) Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Updated April 21, 1999, Received through the CRS Web, 2-16.

¹⁵⁹ Walter Spindler, *Der Beitrag der Bundeswehr zur Bewältigung des KosovoKonflikts Ein Element des internationalen Krisenmanagements im ehemaligen Jugoslaëien* (https://docplayer.org/37273280-Der-beitrag-der-bundeswehr-zur-bewaeltigung-des-kosovo-konflikts-ein-element-des-internationalen-krisenmanagements-im-ehemaligen-jugoslawien-1.html#google_vignette, qasja 20.06.2023).

¹⁶⁰ The legacy of Kosovo: *German politics and policies in the Balkans*, Wolfgang-Uwe Friedrich editor, German Issues, 22, American Institute for Contemporary German Studies The Johns Hopkins University.PDF, 34.

¹⁶¹ Walter Spindler, *Der Beitrag der Bundeswehr zur Bewältigung des KosovoKonflikts Ein Element des internationalen Krisenmanagements im ehemaligen Jugoslawien* (https://docplayer.org/37273280-Der-beitrag-der-bundeswehr-zur-bewaeltigung-des-kosovo-konflikts-ein-element-des-internationalen-krisenmanagements-im-ehemaligen-jugoslaëien-1.html#google_vignette, qasja 20.06.2023).

përdorën për të mbledhur të dhëna nga fusha e zbulimit për njësitë tokësore dhe flukset e refugjatëve. Në kohën e OFA-s, avionët gjermanë nuk ishin të pajisur me PGM për misione goditëse; megjithatë, ata zotëronin raketa kundër rrezatimit AGM-88 HARM dhe kundërmasa të avancuara elektronike, të cilat i lejuan ata të luanin një rol të rëndësishëm në SEAD. Aseti tjetër ajror që Gjermania vendosi me njëfarë suksesi ishte droni i zbulimit CL-289. Të ngarkuar drejtpërdrejt nga Qendra e Operacioneve të Kombinuara Ajrore (CAOC), dronët gjermanë kryen 237 fluturime. Përafërsisht 90% e tyre mblodhën me sukses informacionin dhe u kthyen të sigurt në hapësirën ajrore që kontrollohej nga NATO-ja. Edhe pse gjermanët posedonin vetëm dronë (në krahasim me UAVS-të më të gjithanshëm të aftë për operim autonom), të cilët kanë një kohë dhe shtrirje të kufizuar, dronët ishin ende efektivë në rolin e zbulimit dhe mbikëqyrjes që kishin marrë në Kosovë.¹⁶² Deri në fund të prillit 1999, Gjermania ishte e angazhuar me 14 Tornado (8 anti-radarë, 6 zbulimi), 1 C-160 Transall (Cargo), UAV CL-289, kurse kishte angazhuar afërsisht 4 000 forca tokësore në mbështetje të KFOR-it në Maqedoni, duke përfshirë: 32 tanke leopardi, 32 mjete luftarake të këmbësisë Marder, 30 transportues të blinduar të personelit *Fuchs*, 24 automjete zbulimi *Luchs*, 1 urështruese dhe 10 helikopterë.¹⁶³ Nga pesë anëtarët kryesorë të NATO-s (SHBA, MB, Gjermania, Franca dhe Italia), Gjermania ka përdorur numrin më të vogël të avionëve dhe ka marrë pjesë në numrin më të vogël të avionëve në sulmet ajrore.¹⁶⁴ Aleatët evropianë (Franca, Gjermania, Italia etj.) ndikuan në vendimet taktike në shkallë të ndryshme në Operacionin Forca Aleate. Në fazën

¹⁶² John E.Peters & Stuart Johnson & Nora Bensahel & Timothy Liston & Traci Williams, *European Contributions to Operation Allied Force*, Projekt AIR FORCE, RAND, 2001, 21.

¹⁶³ Kosovo: *Operation “Allied Force”*, 29 APRIL 1999, Tim Youngs, Mark Oakes and Paul Bowers, International Affairs & Defence Section, Mick Hillyard, Economic Policy & Statistics Section, House of Commons Library, 72.

¹⁶⁴ Goduto, Mattheë, “*Analyzing Causes and Consequences of German Military Interventions: Kosovo, Afghanistan, and Iraq*” (2018). Master's Theses and Capstones.

1227(<https://scholars.unh.edu/thesis/1227>, pdf, 15, 16, 17, 18, 19, 21,22,23, 24, qasja 19.09.2023).

e dytë dhe të tretë, Franca dhe në një masë më të vogël Gjermania ishin në gjendje të frenonin përshkallëzimin të fushatës ajrore, e cila ishte përkrahur veçanërisht nga Pentagoni. Përzgjedhja e objektivit (shënjestrës) ishte një proces i gjatë, sfiduese dhe shumë e komplikuar. Raportohet se Gjermania ishte më pak e etur për të përcaktuar vendimmarrjen mbi objektivat (shënjestrat). Rasti i Kosovës demonstroi ambicjet gjermane për të formësuar politikën ndërkombëtare të ndërhyrjes ushtarake dhe të përfitojnë nga aftësitë e saj negociuese për të krijuar një zgjidhje politike të krizës.¹⁶⁵

Gjermania, që në fillim, ka ofruar mbështetje humanitare gjithëpërfshirëse. Gjermania ka pranuar më shumë se 14 000 refugjatë në tokën e saj (më shumë se çdo shtet tjetër në Bashkimin Evropian), avionët e *Bundeswehr*-i bartën më shumë se 2 800 tonë mallra në rajon, duke përfshirë ilaçe, ushqime, rroba dhe tenda; Gjermania ka marrë përgjegjësinë për ndërtimin e disa kampeve të refugjatëve në Shqipëri dhe IRJM me një kapacitet për më shumë se 140 000 njerëz; Qeveria ka dhënë 140 milionë DM ndihmë financiare vetëm në vitin 1999 për qëllime humanitare.¹⁶⁶

Sado që kancelari Shreder deklaroi në një rast se motivi i vetëm dhe vendimtar për pjesëmarrjen e Gjermanisë në Operacionin “Forca Aleate”, ishte ndalimi i vrasjeve në Kosovë¹⁶⁷, si çdo shtet, edhe Gjermania kishte interesa strategjike. Pjesëmarrja e Gjermanisë në operacionin “Forca Aleate” ishte një hap i rëndësishëm për Gjermaninë për të rritur rolin e saj në çështjet botërore. Kosova i bëri

¹⁶⁵ Alliance Politics Under Unipolarity European Influence on Transatlantic Military Interventions, *Dissertation zur Erlangung des Doktorgrades (Dr. rer. pol.)*, Freie Universität Berlin Fachbereich Politik- und Sozialwissenschaften Otto-Suhr-Institut für Politikwissenschaft, Pia Fuhrhop Berlin, März 2014, 126, 139, 221, 226, 227.

¹⁶⁶ The legacy of Kosovo: *German politics and policies in the Balkans*, Wolfgang-Uwe Friedrich editor, *German Issues*, 22, American Institute for Contemporary German Studies The Johns Hopkins University.PDF.

¹⁶⁷ Rede von Bundeskanzler Gerhard Schröder im Rahmen der Haushaltsdebatte zum Haushaltsgesetz 1999 und zum Kosovo-Konflikt vor dem Deutschen Bundestag am 5. Mai 1999 in Bonn: Bulletin 26-99, 6. Mai 1999/PDF/ (<https://www.bundesregierung.de/breg-de/service/bulletin/rede-von-bundeskanzler-gerhard-schroeder-807938>, qasja 28.03.2022).

politikanët gjermanë më të gatshëm për të përdorur forcën jashtë vendit (Afganistan etj.-M.K), veçanërisht pasi OFA-ja ishte kaq e suksesshëm. Elitat gjermane kanë kërkuar gjithashtu një vend të përhershëm në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, prandaj pjesëmarrja në Kosovë dha një shembull shtesë pse Gjermania duhet të jetë anëtare e përhershme e KS-së së OKB-së. Nuk mund të mos pajtohem me mendimin se pjesëmarrja e Gjermanisë në Operacionin “Forca Aleate” ishte një ngjarje historike në Gjermaninë e pas ribashkimit¹⁶⁸. Rëndësia politike e pjesëmarrjes së avionëve gjermanë Tornado në operacionet ajrore, duke përfshirë edhe OFA-n qëndron mbi të gjitha në faktin se Gjermania, për herë të parë si partner i barabartë, mori pjesë në një mision paqëndërtues me forcat e armatosura si pjesë e NATO-s. Në aspektin ushtarak, pjesëtarët e kontingjentit të Forcave Ajrore kanë treguar performancë të njohur profesionale dhe një nivel të lartë motivimi. Kontributi i *Bundeswehr-it* në operacion duhet parë edhe në sfondin e teknologjive dhe kapaciteteve ekzistuese në Aleancë.¹⁶⁹

Edhe **Italia**¹⁷⁰ ishte anëtare themeluese e NATO-s.¹⁷¹ Në kohën e Operacionit, rreth gjysma e opinionit publik i favorizoi sulmet. Italia kishte 6 000 ushtarë dhe marinarë në fushatën e NATO-s. Kishte 1 097 trupa italiane në Maqedoni si pjesë e Korpusit të Reagimit të Shpejtë Aleat të NATO-s (ARRC) dhe 1 800 ushtarë të dedikuar për programin e ndihmës humanitare në Shqipëri, të cilën Italia drejtoi. Italia kishte në dispozicion rreth 54 avionë për fushatën

¹⁶⁸ Goduto, Matthew, “Analyzing Causes and Consequences of German Military Interventions: Kosovo, Afghanistan, and Iraq” (2018). Master’s Theses and Capstones. 1227 (<https://scholars.unh.edu/thesis/1227>, pdf, 15, 16, 17, 18, 19, 21,22,23, 24, qasja 19.09.2023).

¹⁶⁹ Walter Spindler, *Der Beitrag der Bundeswehr zur Beëäaltung des KosovoKonflikts Ein Element des internationalen Krisenmanagements im ehemaligen Jugoslawien* (https://docplayer.org/37273280-Der-beitrag-der-bundeswehr-zur-beäaltung-des-kosovo-konflikts-ein-element-des-internationalen-krisenmanagements-im-ehemaligen-jugoslaeien-1.html#google_vignette, qasja 20.06.2023).

¹⁷⁰ Pierre Milza, *Historia e Italisë* (përkthyer: Asti Papa, Sonila Kora, Nasi Lera. Mariana Ymeri), SHB “Dituria”, Tiranë, 2012.

¹⁷¹ Italy and NATO (https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_162356.htm, qasja 10.01.2023).

ajrore. Italia siguroi më shumë baza për avionët e NATO-s se çdo vend tjetër duke marrë pjesë në fushatë.¹⁷² Pra, kontributi më i madh mbështetës i Italisë erdhi në formën e bazave ajrore.¹⁷³ Italia ishte kontribuesi i tretë më i madh në Operacionin *Forca Aleate* dhe fluturoi në numrin e katërt më të madh të llojeve. Forca Ajrore Italiane vendosi 18 Tornado IDS, 4 Tornado ECR dhe disa avionë AMX (sulmues), duke realizuar afërsisht 1 081 fluturime.¹⁷⁴ Italia mori pjesë në Operacion nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999 me disa lloje avionësh, duke përfshirë F-104, Tornado, AMX dhe AV-8B. Në veçanti, avionët Tornado dhe AMX të Forcave Ajrore arritën gjithsej 1 022 fluturime për 2 828 orë fluturimi, ndërsa 6 AV-8B të hipur në aeroplanmbajtësen Garibaldi të Marinës kryen rreth 50 fluturime dhe 75 orë fluturimi. Në përgjithësi, Italia kontribuoi me 1 072 fluturime dhe 2 903 orë fluturimi në operacion. Përpjekja sasiore dhe cilësore e forcave italiane u vlerësua shumë. Gjatë operacionit, italianët kishin detyra disi më specifike. Për sa i përket Marinës, aktivitetet e AV-8B, fillimisht të kufizuara në mbrojtjen e forcës detare në detin Adriatik, u shtrinë më pas në veprimet e angazhimit në sipërfaqe ajrore me përdorimin e armatimit preciz lazer/infra të kuqe, duke shfrytëzuar aftësitë e përcaktimit të objektivit të ofruara nga asetet aleate. Së fundi, edhe avionët F-104 dhanë një kontribut në misionin e NATO-s, veçanërisht në disa situata emergjente, në të cilat ata duhej të

¹⁷² Turning Point: Operation Allied Force and the Allure of Air Power A thesis presented to the Faculty of the U.S. Army Command and General Staff College in partial fulfillment of the requirements for the degree MASTER OF MILITARY ART AND SCIENCE Art of War Scholars by Robert H. Gregory, Maj, U.S. Army B.S., United States Military Academy, West Point, New York, 2003 M.A., Naval Postgraduate School, Monterey, California, 2008 Fort Leavenworth, Kansas 2014-01, 47.48.49.

¹⁷³ Stefano Monteleone, *24 marzo 1999: venti anni fa iniziava l'operazione Allied Force contro la Serbia*-(<https://www.aviation-report.com/24-marzo-1999-venti-anni-fa-iniziava-operazione-allied-force-contro-la-serbia/>).

¹⁷⁴ John E.Peters&Stuart Johnson&Nora Bensahel&Timothy Liston&Traci Williams, *European Contributions to Operation Allied Force*, Projekt Air Force, Rand, 2001, 21, 22.

zëvendësonin avionët e vendeve të tjera.¹⁷⁵ Në veçanti, Forcat Ajrore Italiane operonin me 24-34 Tornado ADV (8-12), IDS (10) dhe ECR (6-12), 12 F-104 ASA-M, 12 AMX, 2 B-707T/T me të cilët kreu 1 440 dalje dhe 6 555 orë fluturimi, ndërsa *Marina* Italiane operonte me 4 AV-8B Harrier II.¹⁷⁶

Holanda¹⁷⁷ po ashtu si pjesë e NATO-s që nga themelimi i saj,¹⁷⁸ ka dhënë kontribut ushtarak në Operacionin “Forca Aleate”. Më 23 mars 1999, qeveria holandeze ra dakord për pjesëmarrjen në Operacionin “Forcave Aleate” me 16 F-16 holandez, 3 P-3C Orions, 2 fregata dhe 1 nëndetëse. Avioni holandez P-3C Orion, i cili kishte patrulluar mbi Kosovën që nga 13 shkurt 1999 si pjesë e misionit verifikues të NATO-s, u vendos, së bashku me 2 avionë për të fluturuar nga Holanda, nga 24 marsi për patrulla mbi Adriatik, në mbështetje të detit ndërkombëtar. Ushtria holandeze në OFA kishte angazhuar Detashmenti F-16. Detashmenti F-16 në Amendola, i cili mori pjesë prej andej në Operacionin “Forcë e Qëllimshme” mbi Bosnjë, u përforcua me 8 F-16 përpara operacionit. Kjo e çoi numrin e avionëve në 16. Në letër, operacionet ajrore mbi Bosnjë dhe Kosovë ishin të ndara rreptësisht, por në praktikë avionët dhe pilotët nga Operacioni *Deliberate Forge* u vendosën në të dyja zonat. Gjatë ditëve të para të Operacionit, avionët F-16 holandezë mbrojtën formacionet bombarduese të NATO-s. Nga 29 marsi, ata kryen sulmet e tyre në caqet (shënjestrat) tokësore në Jugosllavi. Në fund të prillit, avionët F-16 u pajisën me podin e shënjestrës AN/AAQ-14, që u mundësoi pilotëve holandezë të drejtonin raketën AGM-65G

¹⁷⁵ Vincenzo Camporini, Tommaso De Zan, Alessandro Marrone, Michele Nones, Alessandro R. Ungaro, *Il ruolo dei velivoli da combattimento italiani nelle missioni internazionali: trend e necessità*, Edizioni Nuova Cultura, IAI, Roma, 2014, 42-44.

¹⁷⁶ Stefano Monteleone, *24 marzo 1999: venti anni fa iniziava l'operazione Allied Force contro la Serbia*-(<https://www.aviation-report.com/24-marzo-1999-venti-anni-fa-iniziava-operazione-allied-force-contro-la-serbia/>).

¹⁷⁷ Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 2006, 498, 499.

¹⁷⁸ The Netherlands and NATO

(https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_162354.htm, qasja 10.01.2023).

Maverick të drejtuar me lazer drejt objektivit të saj. Detashmenti u përforcua më 22 prill me 4 F-16 të tjerë të modernizuar. 3 F-16 u zëvendësuan një javë më vonë nga 3 avionë zbulues fotografik RF-16, të cilët mundën të merrnin imazhe më të mira të zonave të bombarduara duke përdorur kamerën moderne MARS. Pilotët holandezë kryen fluturimin e tyre të fundit bombardues më 10 qershor, pas së cilës ata kaluan në fluturime patrullimi. 12 F-16 u kthyen në Holandë më 25 qershor, kurse 8 avionët e mbetur janë përdorur që atëherë në Operacionin “Deliberate Forge” mbi Bosnjë dhe në Operacionin “Joint Guardian” mbi Kosovë.¹⁷⁹ Në kulmin e operacioneve ajrore, Forcat Ajrore Mbretërore të Holandës dislokuan 18 avionë luftarakë F-16A në Ballkan. Këta avionë kryen përafësisht 1 252 fluturime.¹⁸⁰ Holanda kishte furnizuar Operacionin me avionë luftarakë, radarë, helikopterë, avionë për furnizim me karburant dhe një anije luftarake. Në mbrëmjen e parë të sulmeve ajrore të NATO-s, një avion luftarak holandez F-16 rrëzoi një MiG-29 jugosllav. Holanda, gjithashtu, kishte trupa të stacionuara në Maqedoni, kishte dërguar furnizime, kishte mbledhur 40 milionë dollarë ndihmë humanitare publike dhe private dhe ishte zotuar të pranojë deri në 5 000 refugjatë.¹⁸¹

Turqia¹⁸² luajti një rol të rëndësishëm në fillimin e punës së NATO-s për çështjen e Kosovës. Në vjeshtën e vitit 1998, kur tensionet etnike filluan të rriteshin, tema e Kosovës filloi të hyjë më seriozisht në agjendën e Turqisë. Me një vendim të marrë më 8 tetor

¹⁷⁹ Ministry of Defence, *The Dutch contribution to Operation Allied Force* (<https://english.defensie.nl/topics/historical-missions/mission-overview/1999/operation-allied-force/dutch-contribution>, qasja 15.06.2023).

¹⁸⁰ John E. Peters & Stuart Johnson & Nora Bensahel & Timothy Liston & Traci Williams, *European Contributions to Operation Allied Force*, Projekt AIR FORCE, RAND, 2001, 21, 22.

¹⁸¹ CRS Report for Congress, Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes, Karen Donfried (coordinator) Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Updated April 21, 1999, Received through the CRS Web, 2-16).

¹⁸² Erik J. Zürcher, *Historia e Turqisë* (përkthet: Kujtim Ymeri), SHB “Diturua”, Tiranë, 2013.

1998, Kuvendi vendosi pranimin e NATO-s për shkak të krizës në Kosovë. Fillimi i negociatave në Rambuje u konsiderua fillimisht si një zhvillim pozitiv nga Turqia, dështimi i bisedimeve të Rambujesë u prit me shqetësim, por Operacioni “Forca Aleate” i NATO-s u mirëprit nga Turqia. Pas fillimit të operacionit, njësitë ushtarake turke në Traki vihen në gatishmëri. Kryeministri Bülent Ecevit ka deklaruar se në operacion morën pjesë edhe avionët turq F-16, të cilët vepronin si mbrojtje. Avionët luftarakë turq F-16 të vendosur në bazën ajrore Ghedi në Itali, në fillim të operacionit fluturonin vetëm për qëllime mbrojtjeje, kurse në fazat e mëvonshme morën pjesë në veprimet e tyre duke bombarduar në mënyrë aktive objektivat ushtarake serbe.¹⁸³ Turqia, si anëtare e NATO-s, ishte plotësisht pjesëmarrës në OFA. Në fillim të operacionit Turqia kishte angazhuar 11 avionë luftarakë F-16 vetëm për mbrojtjen ajrore dhe një fregatë në detin Adriatik. Në fillim të majit, ajo vendosi 7 avionë të tjerë. Më 12 maj, Turqia kishte rënë dakord të vendoste avionë luftarakë dhe cisterna amerikane në bazat ajrore në Turqinë perëndimore dhe, më 17 maj, konfirmoi se avionët e saj po bombardonin Jugosllavinë. Trupat turke iu bashkuan Operacionit “Porti Aleat” (*Aleat Harbor*) të NATO-s për të ndihmuar refugjatët në Shqipëri.¹⁸⁴

Belgjika¹⁸⁵ e përkrahu dhe mori pjesë në Operacionin “Forca Aleate”, edhe pse pothuajse nuk e lidhte asgjë me Kosovën. Mbështetja e deklaruar e Belgjikës për veprimin e NATO-s bazohej në: afërsinë e krizës dhe frikën se ajo mund të përhapej, dhe fatkeqësia humanitare që kishte filluar të shpalosej në një përsëritje të frikshme të luftës në Bosnjë disa vite më parë. Po aq e rëndësishme ishte nevoja për të treguar solidaritet me aleatët kryesorë evropianë, për qëllime që

¹⁸³ Alptekin Molla, *NATO savunma politikolari çerçevesinde türk-amerikan ilişkilerinin analizi*, Doktora Tezi, T.C. İstanbul Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Uluslararası İlişkiler Anabilim Dalı, İstanbul 2008, 192-200 (qasja 12.02.2022).

¹⁸⁴ CRS Report for Congress, Kosovo: Greek and Turkish Perspectives, Carol Migdalovitz Specialist in Middle Eastern Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Updated May 27, 1999, Received through the CRS Web, 3-4.

¹⁸⁵ Geert Van Istendael, *Historia e Belgjikës (përkthet: Krenar Hajderi)*, SHBT “Dituria”, Tiranë, 2014.

lidhen me avancimin e integritit në Evropë. Publikisht, megjithatë, qeveria belge racionalizoi përfshirjen e saj në veprimet e NATO-s kundër Serbisë kryesisht për arsye humanitare. Në parlament, socialistët, socialdemokratët, kristiandemokratët dhe liberalët ishin gjerësisht në mbështetje të veprimeve të NATO-s. Ky konsensus i gjerë u pasqyrua në opinionin publik belge, me shumicën e belgeve që mbështesin fushatën ajrore kundër Serbisë. Dymbëdhjetë avionë luftarakë belge F-16 u angazhuan në fushatën ajrore kundër Serbisë, megjithëse jo në bombardime strategjike.¹⁸⁶

Kanadaja¹⁸⁷ mori pjesë në OFA, në Operacioni “Porti Aleat” dhe në Operacionin “Determined Force”. Fillimisht, në OFA, Kanada kishte një angazhim fillestar prej gjashtë CF-188 Hornets (një angazhim që përfundimisht u rrit në 18 avionë), që vepronin nën emrin Operacioni “ECHO” (emërtimi kanadez i operacionit). Në mbështetje të operacioneve ajrore dhe detare ishin avionët E3A të Forcave të Paralajmërimit të Hershëm Ajror të NATO-s (NAEWF). Dy E3A ishin në ajër gjatë gjithë kohës së operacionit, duke fluturuar dy orbita. Një avion i tretë ishte gjithmonë në gatishmëri. E3 u dha komandantëve një pamje të qartë të operacioneve ajrore, si dhe drejtimin dhe kontrollin e mbi 1 000 fluturimeve në ditë. Avionët luftarakë të aleatëve që rrëzuan gjashtë avionë luftarakë serbë MIG 29 kontrolloheshin nga E3A. Pjesëmarrja ajrore kanadeze në Operacionin Forca Aleate vazhdoi në Operacionin “Determined Force”.¹⁸⁸ Që nga 24 marsi, aeroplanët kanadezë morën pjesë në OFA.

¹⁸⁶ David Haglund & Allen Sens, “Kosovo and the Case of the (Not So) Free Riders: Belgium, Canada, Portugal and Spain”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention, Peace and Governance Programme* The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur

(https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 09.11.2022).

¹⁸⁷ Desmond Morton, *Historia e Kanadasë* (përktheu: Kujtim Ymeri), SHBT “Dituria”, Tiranë, 2016.

¹⁸⁸ Operation Allied Force (NAEWF) (<https://www.canada.ca/en/department-national-defence/services/military-history/history-heritage/past-operations/europe/naewf.html>, qasja 10.01.2023).

Gjatë 78 ditëve dhe netëve që pasuan, gjashtë, pastaj dymbëdhjetë, pastaj tetëmbëdhjetë CF 18 kanadezë nga Aviano kryen gjithsej 678 fluturime luftarake mbi gati 2 600 orë fluturime. Ata dorëzuan 532 bomba (gati gjysmëmilioni funta municione me eksploziv të lartë) duke përfshirë 361 nga variantet 502 mijë funta të drejtuar me lazer në një sërë objektivash në mbarë Kosovën dhe Republikën Federative të Jugosllavisë, të gjitha pa humbje për ekuipazhin dhe avionët kanadezë pjesëmarrës.¹⁸⁹ Kanada mori pjesë edhe në Operacionin “Porti Aleat” nga data 9-17 prill 1999.¹⁹⁰ Kanada luajti rol në luftën ajrore, në proporcion me atë të Francës dhe të Britanisë dhe krejt ndryshe nga ai i aleatëve të tjerë “më të vegjël”. Mund ta bënte këtë, sepse kishte atë që i mungonte shumicës së forcave të tjera ajrore aleate (jo-SHBA): raketa të drejtuar me saktësi (PGM) të afta të lëshoheshin nga 18 bombarduesit luftarakë CF-18 të vendosura në teatër. Nëse NATO-ja ka kryer më shumë se 27 000 fluturime (sulme dhe të tjera) gjatë operacionit; nga ai total, avionët kanadezë kryen 678 fluturime (në atë që Kanadaja e quajti *Operacioni Echo*). Megjithëse numri i avionëve pjesëmarrës nga Kanadaja ishte afërsisht i krahasueshëm me ata të furnizuar nga disa aleatë të tjerë, operativisht Kanadaja ishte shumë më e rëndësishme se shumica, me përjashtim të Forcave Ajrore të SHBA-së (USAF). Pilotët kanadezë, për shkak se kishin PGM-të dhe gjithashtu për shkak të nivelit të tyre të lartë të trajnimit dhe ndërveprimit të tyre të lartë me USAF, fluturuan gati 10 për qind të të gjitha fluturimeve gjatë operacionit. Po ashtu, numri dërrmues i

¹⁸⁹ Lieutenant-Colonel David L. Bashow, Colonel Dwight Davies, Colonel André Viens, Lieutenant-Colonel John Rotteau, Major Norman Balfe, Major Ray Stouffer, Captain James Pickett and Dr. Steve Harris, “Mission Ready: Canada’s role in the Kosovo Air Campaign”, Canadian Military Journal, Vol.1, No.1, Spring 2000, 55-61 (<http://www.journal.forces.gc.ca/vol1/no1/doc/55-61-eng.pdf>, qasja e fundit 10.01.2023).

¹⁹⁰ Operation Allied Harbour, Date modified: 2018-12-11 (<https://www.canada.ca/en/department-national-defence/services/military-history/history-heritage/past-operations/europe/mikado.html>, qasja 10.01.2023).

“paketave” goditëse të dërguara mbi qiellin serb udhëhiqej ose nga amerikanët ose kanadezët.¹⁹¹

Përgjigjja e **Portugalisë**¹⁹² ndaj krizës së Kosovës ishte e ngjashme me qasjen e miratuar nga Belgjika. Detyrimet ndaj aleancës dhe Evropës si dhe imperativi humanitar, u përmendën në justifikimin e veprimit të NATO-s. Pjesëmarrja portugeze do të përbëhet nga tre avionë F-16 dhe një forcë prej 53 anëtarësh të Forcave Ajrore Portugeze, në teatrin e operacioneve, përveç fluturimeve të nevojshme mbështetëse.¹⁹³ Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Portugalisë, më 29 maj 1999, lëshon Urdhëresën nr.392/99, që të riformatohet përbërja e detashmentit të Forcave Ajrore Portugeze të stacionuar në Aviano të Italisë, në shërbim të organizatës ndërkombëtare të lartpërmendur, për ta përshtatur atë me kërkesat e reja operacionale. Sipas urdhëresës në fjalë, pjesëmarrja portugeze përbëhet nga tre avionë F-16, me një tjetër gati në territorin kombëtar dhe një forcë prej 59 elementësh të Forcave Ajrore, të cilat mund të rriten në maksimum 65 elementë”.¹⁹⁴ Për çështjen e Kosovës është diskutuar edhe në Seanca Plenare të Parlamentit Portugez gjatë kohës kur po zhvillohej operacioni.¹⁹⁵

¹⁹¹ David Haglund & Allen Sens, “Kosovo and the Case of the (Not So) Free Riders: Belgium, Canada, Portugal and Spain”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention*, Peace and Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur

(https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 9.11.2022).

¹⁹² Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 2006, 1013.

¹⁹³ Portaria n.º 946/98, de 31 de outubro, Autoriza o Chefe do Estado-Maior-General das Forças Armadas a aprontar, sustentar e empregar as forças que constituirão a participação militar portuguesa nas operações da OTAN relativas ao Kosovo, Portaria n.º 946/98 de 31 de Outubro (<https://diariodarepublica.pt/dr/detalhe/portaria/946-1998-222776>, qasja 07.07.2024).

¹⁹⁴ Portaria n.º 392/99, de 29 de maio, Altera a Portaria n.º 946/98, de 31 de Outubro (define a participação militar portuguesa nas operações aéreas da NATO no Kosovo) (<https://diariodarepublica.pt/dr/detalhe/portaria/392-1999-316715>, qasja 07.07.2024).

¹⁹⁵ Debates Parlamentares, VII Legislatura 4.ª Sessão Legislativa (1998-1999) REUNIÃO PLENÁRIA DE 13 DE MAIO DE 1999, DIÁRIO da Assembleia da República, Sexta-feira, 14 de Maio de 1999 I Série - Número 85, Página 3051 (<https://debates.parlamento.pt/catalogo/r3/dar/01/07/04/085/1999-05-13?sft=true&pgs=3090&org=PLC&plcdf=true#p3051>, qasja 07.07.2024).

Portugalia ka dhënë edhe kontribut humanitar.¹⁹⁶ Gjithashtu, më 25 maj 1999, Këshilli i Ministrave kishte vendosur t’u japë mbrojtje të përkohshme, për një periudhë fillestare deri në gjashtë muaj, qytetarëve të Kosovës, që shkonin drejtpërdrejt nga rajoni, jeta ose integriteti fizik i të cilëve ishte kërcënuar drejtpërdrejt.¹⁹⁷ Portugalia kishte vendosur të jetë edhe pjesë e KFOR-it në Kosovë.¹⁹⁸

Spanja¹⁹⁹ ishte një nga forcat ajrore të pakta aleate që mori pjesë në bombardimet strategjike. Avionët spanjollë F-18 (të pajisur me bomba të drejtuara me lazer) ishin në valën e parë të sulmeve më 24 mars 1999. Deri në fillim të qershorit, kanë kryer rreth 200 fluturime, nga të cilat 160 ishin fluturime goditëse. Ushtarakisht, për një vend me një forcë të armatosur rreth tri herë më të madhe se sa ajo e Kanadasë, Spanja duket se e ka rafinuar artin e “ndarjes së barrës” në një mënyrë mjaft ekonomike, duke bërë më shumë se Portugalia dhe Belgjika, por më pak se Kanadaja. Ajo përfundimisht angazhoi tetë avionë F-18 në Operacionin e Forcave Aleate, dhe gjithashtu lejoi avionët ushtarakë amerikanë në rrugën për në Serbi të përdorin bazat në tokën spanjolle.²⁰⁰ Llojet e 8 avionëve të Spanjës që morën pjesë në

¹⁹⁶ Resolução do Conselho de Ministros n.º 29/99, de 22 de abril, Ajuda humanitária de emergência aos refugiados do Kosovo, Resolução do Conselho de Ministros n.º 29/99 (<https://diariodarepublica.pt/dr/detalhe/resolucao-conselho-ministros/29-1999-534627>, qasja 07.07.2024).

¹⁹⁷ Resolução do Conselho de Ministros n.º 44/99, de 25 de maio, Concede protecção temporária, por um período inicial de seis meses, aos cidadãos do Kosovo, Resolução do Conselho de Ministros n.º 44/99 (<https://diariodarepublica.pt/dr/detalhe/resolucao-conselho-ministros/44-1999-317119>, qasja 07.07.2024).

¹⁹⁸ Portaria n.º 566/99, de 28 de julho, Autoriza o Chefe do Estado-Maior-General das Forças Armadas a aprontar, sustentar e empregar as forças que constituirão a missão das Forças Armadas Portuguesas na força militar para o Kosovo (KFOR), Portaria n.º 566/99 de 28 de Julho (<https://diariodarepublica.pt/dr/detalhe/portaria/566-1999-345513>, qasja 07.07.2024)

¹⁹⁹ Fernando Garcia De Cortazar de Cortazar & Jose Manual GonzalesVesga, *Historia e Spanjës* (përkthyen: Anila Bitri, Sonila Kora, Kujtim Ymeri), SHB “Dituria”, Tiranë, 2012.

²⁰⁰ David Haglund & Allen Sens, “Kosovo and the Case of the (Not So) Free Riders: Belgium, Canada, Portugal and Spain”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention*, Peace and Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur (https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 9.11.2022).

OFA ishin: C-15 (EF-18), 3 T-10 (KC-130) dhe 2 T-12 (CASA-212).²⁰¹

Danimarka²⁰² miratoi një pozicion “ndiq liderin” dhe nuk tregoi asnjë hezitim kur ishte fjala për lëshimin e kërcënimeve kundër RFJ-së.²⁰³ Gjatë Operacionit *Forca Aleate* kundër Jugosllavisë, për herë të parë ndodhi që avionët danezë F-16 të përfshiheshin drejtpërdrejt në luftime. Nga popullata daneze, pati një mbështetje të madhe për ndërhyrjen e NATO-s. Në prill, NATO-ja vendosi të zgjerojë forcën ajrore në zonë në rreth 1 000 avionë, kurse kontributi danez u rrit nga katër në tetë avionë F-16.²⁰⁴ Kontributit ushtarak danez në luftën e NATO-s iu shtuan edhe katër avionë shtesë dhe 150 trupa për AFOR-in (Forca Shqiptare). Gjatë gjithë luftës, pjesa më e madhe e kontributit ushtarak të Danimarkës ishte për funksionet mbështetëse dhe jo për luftime. Megjithatë, më 26 maj 1999, pilotët danezë hodhën bombat e tyre të para.²⁰⁵ Avionët danezë F-16 nga baza

²⁰¹ Federico Yaniz Velasco, The impact of NATO on the Spanish Air Force: A historical overview and future prospects, Copyright © UNISCI, 2010, 237.

²⁰² Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 2006, 251-252.

²⁰³ Ph.D.-afhandling af Søren Nørby, *Når fjenden forsvinder. Det danske flyvevåbens omstilling fra Berlinmurens fald 1989 til krigen over Libyen 2011*, Syddansk Universitet, Institut for Historie. Februar 2018., 113-127; Anders Wivel, Hvorfor bidrog Danmark militært i Kosovo, Afghanistan og Irak?, February 2019, 375-402; Forsvarsministeren, Årlig redegørelse 1999, marts 2000, 21-26; Bjørn Møller, “The Nordic Countries: Whither the West’s Critical Conscience?”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention* (Selective Indignation, Collective Intervention, and International Citizenship), Peace and Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 09.11.2022).

²⁰⁴ Jugoslavien - Operation Allied Force (<https://www.forsvaret.dk/da/opgaver/afsluttede-operationer/jugoslavien/jugoslavien---operation-allied-force/>, qasja 20.06.2023).

²⁰⁵ Ph.D.-afhandling af Søren Nørby, *Når fjenden forsvinder. Det danske flyvevåbens omstilling fra Berlinmurens fald 1989 til krigen over Libyen 2011*, Syddansk Universitet, Institut for Historie. Februar 2018., p. 113-127; ANDERS WIVEL, Hvorfor bidrog Danmark militært i Kosovo, Afghanistan og Irak?, February 2019, p. 375-402; Forsvarsministeren, Årlig redegørelse 1999, marts 2000, p.21-26; Bjørn Møller, “The Nordic Countries: Whither the West’s Critical Conscience?”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention* (Selective Indignation, Collective Intervention, and International Citizenship), Peace and

ajrore në Itali morën pjesë aktive në operacionet ajrore të NATO-s kundër ish-Jugosllavisë. Një total prej përafërsisht 600 fluturime (një fluturim me një avion) që korrespondojnë me përafërsisht 2 250 orë fluturimi. Detyrat ishin kryesisht misione të mbrojtjes ajrore, ku avionët danezë patrullonin hapësirën ajrore dhe në këtë mënyrë mbronin avionët dhe anije të tjera të NATO-s. Avionët danezë u vendosën edhe në operacione ofensive, ku u kryen sulme kundër objektivave ushtarake në ish-Jugosllavi. Në total, avionët hodhën 24 bomba.²⁰⁶ Danimarka pranoi një numër të vogël prej 1 500 refugjatësh të përkohshëm (më vonë u rrit në 3 000), shumica e të cilëve nuk mbërritën kurrë.²⁰⁷ Më gjerësisht për kontributin e danezëve shih fusnotat.²⁰⁸

Norvegjia²⁰⁹ pavarësisht se ishte në kufij me Rusinë, mori pjesë dhe kontribuoi në operacionin “Forca Aleate”, por vetëm si pjesë e asaj që komandanti i operacionit ajror, gjenerali Michael C.

Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 09.11.2022.

²⁰⁶ Jugoslavien - Operation Allied Force (<https://www.forsvaret.dk/da/opsaver/afsluttede-operationer/jugoslavien/jugoslavien---operation-allied-force/>, qasja 20.06.2023).

²⁰⁷ Ph.D.-afhandling af Søren Nørby, *Når fjenden forsvinder. Det danske flyvevåbens omstilling fra Berlinmurens fald 1989 til krigen over Libyen 2011*, Syddansk Universitet, Institut for Historie. Februar 2018., 113-127; Anders Wivel, *Hvorfor bidrog Danmark militært i Kosovo, Afghanistan og Irak?*, February 2019, 375-402; Forsvarsministeren, *Årlig redegørelse 1999, marts 2000*, p.21-26; *Bjørn Møller*, “The Nordic Countries: Whither the West’s Critical Conscience?”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention* (Selective Indignation, Collective Intervention, and International Citizenship), Peace and Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 09.11.2022).

²⁰⁸ Ph.D.-afhandling af Søren Nørby, *Når fjenden forsvinder. Det danske flyvevåbens omstilling fra Berlinmurens fald 1989 til krigen over Libyen 2011*, Syddansk Universitet, Institut for Historie. Februar 2018., 113-127; Anders Wivel, *Hvorfor bidrog Danmark militært i Kosovo, Afghanistan og Irak?*, February 2019, 375-402; Forsvarsministeren, *Årlig redegørelse 1999, marts 2000*, 21-26.

²⁰⁹ Ovind Stevensen, Ivar Libaek, *Historia e Novergjisë* (përktheu: Mira Kroqi), SHB “Dituria”, Tiranë, 2015.

Short, më vonë iu referua si “Ekipi B”. Kontributi ushtarak ajror norvegjez në OFA përbëhej kryesisht nga gjashtë avionë luftarakë F-16 nga skuadrilja 338, të cilët ishin në gatishmëri të NATO-s të caktuar për operacione të huaja që nga viti 1993. Avionët ishin një model më i vjetër se ai avionit të sotëm F-16, i quajtur OCU. Kontributi norvegjez u përdor kryesisht për të kryer të ashtuquajturat patrulla ajrore luftarake (CAP) mbi zonën e Ballkanit. Kur jemi te kontributi norvegjez, duhet thënë se norvegjezët kanë kryer rreth 350 fluturime në OFA, pa u përfshirë drejtpërdrejt në situata luftarake as në ajër, as kundër objektivave tokësorë. Në të njëjtën kohë, avionët përdorshin vetëm për të patrulluar hapësirën ajrore - ata nuk morën pjesë aktive në fushatën e bombardimeve.²¹⁰ Norvegjia kontribuoi me personel tokësor dhe ajror në Operacionin “Syri i shqiponjës” (“Eagle Eye”),²¹¹ kurse në OFA me skuadrilen 338. Gjatë kohës sa zgjati operacioni, avionët norvegjezë morën pjesë në patrulla ajrore, përcjellje dhe fluturime luftarake mbi Kosovë dhe fluturuan mbi 2 000 orë. Skuadrilja u kthye në Norvegji në gusht të vitit 1999, atëherë kur KFOR- i ishte vendosur në Kosovë.²¹² Në Operacionin AFOR Norvegjia kontribuoi me 12 oficerë. Mes tyre, një oficer shërbeu si zëdhënës i shtypit i NATO-s në kryeqytetin e Shqipërisë (Tiranë).²¹³

Greqia²¹⁴ edhe pse nuk u përfshi drejtpërdrejt në operacione ajrore, ajo nuk vuri veton ndaj operacionit të NATO-s, e fajësoi presidentin jugosllav Slobodan Millosheviq për dështimin për të arritur një marrëveshje paqeje, por edhe përmbushi angazhimet e

²¹⁰ Gabriel Husby, “Norske kampfly i krig Bombing på klare betingelser?”, Militære Studier, Forsvarets Stabsskole, 3-4 2016, 47, 48, 49, 50, 51, 52 (<https://fhs.brage.unit.no/fhs-xmlui/bitstream/handle/11250/2390086/MS-316-blapdf.pdf?sequence=3&isAlloëed=y>, qasja e fundit 10.01.2023).

²¹¹ Kosovo Operation Eagle Eye 1998-1999

(<https://www.itjenestefornorge.no/operasjon/operation-eagle-eye>, qasja 10.04.2024).

²¹² Operation Allied Force 1999 (<https://www.itjenestefornorge.no/operasjon/operation-allied-force>, qasja 10.04.2024).

²¹³ Albanian Force (AFOR) 1999 (<https://www.itjenestefornorge.no/operasjon/albanian-force-afor>, qasja 10.04.2024).

²¹⁴ Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 421-422.

aleancës duke i mbajtur të hapura portet dhe linjat e karburantit për NATO-n.²¹⁵ Trupat greke ndihmuan refugjatët në Shqipëri dhe IRJM. Një grup mjekësor grek ishte organizata e parë joqeveritare e ndihmës humanitare që Beogradi lejoi në Kosovë. Ishte deklaruar se do të kontribuonte në një forcë paqeruajtëse të mandatuar nga OKB-ja nëse të gjitha palët, përfshirë Jugosllavinë, bien dakord.²¹⁶

Polonia²¹⁷, Hungaria dhe Republika Çeke u bënë anëtare të NATO-s më 12 mars 1999.²¹⁸ Milada Anna Vachudová, një eksperte për Evropën postkomuniste, thekson se qeveria e Polonisë ishte ndër më mbështetësit politikisht të ndërhyrjes brenda NATO-s. Sondazhet e opinionit raportuan se shumica e publikut të Polonisë e miratoi fushatën ajrore.²¹⁹ Qeveria polake i dha mbështetje të fortë misionit të NATO-s, e mbështetur nga vlerësime të forta publike (që variojnë nga rreth 50% në mbi 60%) dhe konsensus në të gjithë spektrin politik. Qeveria polake deklaroi se veprimi ushtarak i NATO-s ishte i justifikuar, pasi përpjekjet diplomatike për të ndalur spastrimin etnik të Kosovës dhe për të ndalur agresionin serb ishin shteruar.²²⁰ Polonia

²¹⁵ CRS Report for Congress, Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes, Karen Donfried (coordinator) Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Updated April 21, 1999, Received through the CRS Web, 2-16.

²¹⁶ CRS Report for Congress, Kosovo: Greek and Turkish Perspectives, Carol Migdalovitz Specialist in Middle Eastern Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Updated May 27, 1999, Received through the CRS Web, 4.

²¹⁷ Jerzy Lukowsky, Hubert Zawaidshi, *Historia e Polonisë* (përktheu: Erblina Kërcishta), SHB “Ditura”, Tiranë, 2014.

²¹⁸ CRS Report for Congress, Received through the CRS Web, *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division Congressional Research Service ÷ The Library of Congress, November 19, 1999, 17,18,19).

²¹⁹ John-Michael Arnold, *Responsibilities of Alliance: Czech, Hungarian, and Polish Contributions During and After NATO’s Kosovo Intervention*, 572 (<https://transatlanticrelations.org/ép-content/uploads/2019/04/25-arnold.pdf>, qasja 15.12.2022).

²²⁰ CRS Report for Congress, Received through the CRS Web, *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division Congressional Research Service ÷ The Library of Congress, November 19, 1999, 17,18,19.

nuk kontribuoi me forca luftarake ose avionë mbështetës në OFA,²²¹ por dërgoi 140 ushtarë në Forcën Shqiptare (AFOR) të udhëhequr nga NATO-ja, e cila ofroi ndihmë humanitare për refugjatët kosovarë.²²² Qeveria polake ofroi qasje të plotë në aeroportet e Polonisë avionëve të NATO-s që merrnin pjesë në OFA.²²³ Zyrtarët polakë ishin ndër të parët që sugjeruan bombardimin e stacioneve televizive dhe radiofonike serbe për të shtypur makinën propagandistike të Millosheviqit. Për më tepër ata ishin të vendosur në parim për të mbështetur idenë e plotësimit të sulmeve ajrore me operacione tokësore.²²⁴

Çekia²²⁵ përjetoi debatin politik më të diskutueshëm në lidhje me Operacionin “Forca Aleate”. Sondazhet e opinionit zbuluan se vetëm 35 për qind e publikut çek e miratonin fushatën.²²⁶ Përkrähësi më i shquar, brenda Republikës Çeke, i ndërhyrjes së NATO-s, ishte

²²¹ CRS Report for Congress, Received through the CRS Web, *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division Congressional Research Service ÷ The Library of Congress, November 19, 1999, 17,18,19).

²²² John-Michael Arnold, *Responsibilities of Alliance: Czech, Hungarian, and Polish Contributions During and After NATO’s Kosovo Intervention*, 572 (<https://transatlanticrelations.org/ép-content/uploads/2019/04/25-arnold.pdf>, qasja 15.12.2022)

²²³ CRS Report for Congress, Received through the CRS Web., *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Congressional Research Service ÷ The Library of Congress, November 19, 1999, 17,18,19.

²²⁴ Péter Tálas&László Valki, “The New Entrants: Hungary, Poland and the Czech Republic”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention*, Peace and Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 9.11.2022).

²²⁵ Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 2006, 243, 244

²²⁶ John-Michael Arnold, *Responsibilities of Alliance: Czech, Hungarian, and Polish Contributions During and After NATO’s Kosovo Intervention*, 573-575 (<https://transatlanticrelations.org/ép-content/uploads/2019/04/25-arnold.pdf>, qasja 15.12.2022).

presidenti Václav Havel.²²⁷ Presidenti Havel jo vetëm që ofroi mbështetje të fortë për fushatën e NATO-s, por edhe kritikoi qeverinë për krijimin e një përshtypjeje të paqartë për mbështetjen çeke.²²⁸ Qeveria miratoi hapjen e hapësirës ajrore dhe aeroporteve çeke për avionët ushtarakë aleatë deri më 6 prill. Përkundër faktit se të gjitha partitë politike premtuan mbështetjen e tyre për propozimin e qeverisë, ai u miratua nga Kuvendi vetëm pas pesë orësh debati të furishëm (me 145 përfaqësues nga 181 të pranishëm në mbështetje të votimit).²²⁹ Me gjithë ndarjet e saj politike mbi këtë çështje, Republika Çeke dha kontribut të kufizuar në fushatën ajrore. Ajo vendosi një spital fushor dhe një avion transporti në përpjekjet e NATO-s për ndihmën humanitare në Shqipëri.²³⁰ Pavarësisht nga retorika e lëkundur politike, Çekia i dha NATO-s përdorimin e hapësirës së saj ajrore, tranzitit përmes territorit të saj dhe aeroporteve si dhe lehtësira të tjera të transportit gjatë fushatës ajrore.²³¹

²²⁷ John-Michael Arnold, *Responsibilities of Alliance: Czech, Hungarian, and Polish Contributions During and After NATO’s Kosovo Intervention*, 573-575 (<https://transatlanticrelations.org/ép-content/uploads/2019/04/25-arnold.pdf>, qasja 15.12.2022).

²²⁸ CRS Report for Congress, Received through the CRS Web, *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Congressional Research Service ò The Library of Congress, November 19, 1999, 17,18,19.

²²⁹ Péter Tálas&László Valki, “The New Entrants: Hungary, Poland and the Czech Republic”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention*, Peace and Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 9.11.2022).

²³⁰ John-Michael Arnold, *Responsibilities of Alliance: Czech, Hungarian, and Polish Contributions During and After NATO’s Kosovo Intervention*, 573-575 (<https://transatlanticrelations.org/ép-content/uploads/2019/04/25-arnold.pdf>, qasja 15.12.2022).

²³¹ CRS Report for Congress, Received through the CRS Web., *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division Congressional Research Service ò The Library of Congress, November 19, 1999, 17,18,19.

Hungaria²³² e vetmja anëtare e NATO-s që ndante një kufi me Jugosllavinë dhe kishte interesa të drejtpërdrejta kombëtare në rrezik, pati një përgjigje të përzier ndaj veprimit të NATO-s kundër Jugosllavisë. Edhe pse e shqetësuar për fatin e pakicës etnike hungareze në Vojvodinë, shumica e hungarezëve mbështetën fushatën ajrore të NATO-s në sondazhet e opinionit publik.²³³ Qeveria hungareze mbështeti vazhdimisht fushatën ajrore kundër Jugosllavisë dhe mori pjesë aktive duke hapur hapësirën e saj ajrore dhe aeroportet për avionët e NATO-s. Operacionin e NATO-s e miratuan edhe partitë opozitare.²³⁴ Pas disa hezitimeve, Hungaria i dha NATO-s përdorimin e hapësirës së saj ajrore dhe aeroportet, të cilat NATO-ja i përdori për të nisur disa nga sulmet gjatë operacionit. Gjatë përplasjes së qershorit midis NATO-s dhe paqeruajtësve rusë në aeroportin e Prishtinës, Hungaria ishte vendi i parë që ia mohoi Ruisë të drejtën e fluturimit për të përforcuar paqeruajtësit e saj.²³⁵ András Simonyi, ambasadori i parë i Hungarisë në NATO, kujton se si qeveria e vendit ishte shumë e vetëdijshme se përfshirja e saj në operacion mund të shkaktonte që Millosheviqi të hakmerrej kundër hungarezëve etnikë në Serbi.²³⁶ Në

²³² Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 2006, 509.

²³³ CRS Report for Congress, Received through the CRS Web., *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Congressional Research Service ò The Library of Congress, November 19, 1999, 17,18,19.

²³⁴ Péter Tálas&László Valki, "The New Entrants: Hungary, Poland and the Czech Republic", *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention*, Peace and Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 09.11.2022).

²³⁵ CRS Report for Congress, Received through the CRS Web., *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Paul E. Gallis, Coordinator Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Congressional Research Service ò The Library of Congress, November 19, 1999, 17,18,19.

²³⁶ John-Michael Arnold, *Responsibilities of Alliance: Czech, Hungarian, and Polish Contributions During and After NATO's Kosovo Intervention*, 572 (<https://transatlanticrelations.org/ép-content/uploads/2019/04/25-arnold.pdf>, qasja 15.12.2022).

prill 1999, Hungaria dërgoi 35 specialistë të shëndetit publik për të ndihmuar refugjatët në Shqipëri.²³⁷ Hungaria nuk kontribuoi me asnjë avion në Operacionin *Forca Aleate*.²³⁸ Për rolin dhe kontributin e **Islandës**²³⁹ dhe **Luksemburgut**,²⁴⁰ nuk mund të japin ndonjë të dhënë në rastin konkret, sepse ai ka qenë kryesisht retorik.

Me gjithë divergjencat mes shteteve anëtare të NATO-s si rezultat i interesave të ndryshme, me gjithë pikëpamjet e ndryshme nëse duhej apo jo aprovimi nga OKB-ja dhe nëse ishte ligjore ndërhyrja ushtarake, apo nëse duhej të lihej Kosova dhe populli i saj nën mëshirën e një shteti kriminal siç ishte Jugosllavia, NATO-ja vendosi që të përdorte forcën ushtarake për ta ndaluar gjenocidin e Serbisë në Kosovë.

Më 24 mars 1999, 19 shtetet anëtare të NATO-s, në krye me SHBA-në, vendosën unanimitisht për fillimin e Operacionit “Forca Aleate” për ta ndërprerë gjenocidin e Serbisë në Kosovë, për ta ndërprerë katastrofën humanitare dhe për ta ruajtur sigurinë rajonale dhe përshkallëzimin e luftës në nivel rajonal. U deshën 19 shtete anëtare të jepnin pajtimin për fillimi e operacionit, 13-14 shtete të merrnin pjesë në OFA me forcat e tyre ushtarake, përdorimi i mbi 1 000 aeroplanëve ushtarakë, hedhja e mijëra raketave e bombave, për 78 ditë me radhë të realizoheshin mbi 38 000 fluturime, të

²³⁷ John-Michael Arnold, *Responsibilities of Alliance: Czech, Hungarian, and Polish Contributions During and After NATO’s Kosovo Intervention*, 572

(<https://transatlanticrelations.org/ep-content/uploads/2019/04/25-arnold.pdf>, qasja 15.12.2022.

²³⁸ CRS Report for Congress, *Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes*, Karen Donfried (coordinator) Specialist in European Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, Updated April 21, 1999, Received through the CRS Web, 2-16); Bjørn Møller, “The Nordic Countries: Whither the West’s Critical Conscience?”, *Kosovo and the challenge of humanitarian intervention* (Selective Indignation, Collective Intervention, and International Citizenship), Peace and Governance Programme The United Nations University, Edited by Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm#11; https://archive.unu.edu/p&g/kosovo_full.htm, qasja 09.11.2022).

²³⁹ Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 2006, 537

²⁴⁰ Enciklopedia e Përgjithshme e Oxfordit (përkthyer nga origjinali: Abdurrahim Myftiu, Aleko Minga, Xhevat Lloshi), IDK, Tiranë, 2006, 537.

shpenzoheshin miliardë dollarë, funta, marka, franga e lireta dhe të bombardoheshin caqe ushtarake në Serbi, Mal të Zi e në Kosovë. Për NATO-n, si organizata më e fuqishme ushtarake në botë, nuk ishte e lehtë të arrinte deri te përdorimi i forcës, të bënte luftën që bëri, por njëkohësisht ta ruante unitetin dhe kohezionin brenda saj, t’i tejkaloje mospajtimet dhe divergjencat mes shteteve, kombeve e ushtrive për çështje të planifikimit, të komandës dhe të kontrollit, objektivave politike, diplomatike, ushtarake, strategjike dhe gjeopolitike.

Për NATO-n, gjithashtu, nuk ishte i lehtë përcaktimi i caqeve që duhej të godiste, nuk ishte i lehtë përcaktimi për fazat e operacionit dhe përshkallëzimit të luftimeve për t’i realizuar objektivat e synimet e saj. Mirëpo NATO-ja, pavarësisht divergjencave, arriti t’i tejkaloje presionet dhe pengesat me të cilat u ballafaqua, arriti të dëshmojë vetën. Ajo i realizoi objektivat e saj. Ky ishte një sukses i madh në 50-vjetorin e themelimit të saj. Suksesi më i madh për NATO-n dhe UÇK-në ishte ndërprerja e katastrofës humanitare, ishte largimi i të gjitha forcave pushtuese jugosllave nga Kosova, shpëtimi i një populli nga zhbërja, ruajtja e sigurisë rajonale dhe fillimi i një jete të re për Kosovën dhe popullin e saj. Për suksesin e NATO-s kundër RFJ-së në Operacionin “Forca Aleate”, kanë shkruar krerë të shteteve dhe të qeverive, ministra të Jashtëm, historianë, ushtarakë, intelektualë, studiues fushash të ndryshme; gazetarë e analistë të mediave të shkruara dhe elektronike. Për luftën e NATO-s në Kosovë kundër RFJ-së dhe Serbisë janë publikuar mijëra artikuj të gazetave dhe revistave prestigjioze botërore; janë ruajtur dokumente arkivore të organizatave dhe shteteve.

Edhe pse për Kosovën, për luftën e saj 1997-1999, për krizën rajonale dhe botërore të quajtur Kosovë, janë ruajtur dokumente arkivore në arkiva të ndryshëm, janë shkruar qindra libra, janë mbrojtur disa teza disertacionesh në disa universitete prestigjioze ndërkombëtare, janë publikuar mijëra artikuj në disa gjuhë, janë bërë dokumentarë, analiza e studime të shumta, ka mbetur shumë, tejet shumë pa u thënë dhe pa u shkruar në historiografinë shqiptare. Është koha që historiografia shqiptare ta thotë fjalën e saj. Në mos qoftë

vonuar, tani është koha. Është e nevojshme, është e domosdoshme që nxënësit tanë, studentët, studiuesit, inteligjencia, populli ynë dhe bota të lexojnë e mësojnë të vërtetën e luftës së Kosovës 1997-1999. Misioni dhe synimi im është t’i shërbej kësaj të vërtete historike.